

INTERVISTË ME HIDAJETE SHABANI DËRMAKUN

Prishtinë | Data: 17 tetor, 2022

Kohëzgjatja: 189 minuta

Të pranishëm:

1. Hidajete Shabani Dërmaku (E intervistuar)
2. Anita Susuri (Intervistuesja)
3. Renea Begolli (Kamerë)
4. Urtesë Zeneli (Prezente)

Simbolet e komenteve në transkriptë të komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.

Pjesa e Parë

Anita Susuri: Zonja Hidajete, nëse mundeni me u prezantu, datën e lindjes, diçka për familjen e juaj të parë?

Hidajete Shabani Dërmaku: Unë jam Hidajete Dërmaku e lindur me 18.12.1953 në fshatin Përlepnice. Prej babait Hysen Shabanit e nana është Eshrefe Ramadani, e fshatit Malishevë afër Gjilanit.

Anita Susuri: E baba juaj, me çka osht' marrë?

Hidajete Shabani Dërmaku: Baba im është marrë me, ka qenë mbathëtar. I ka mbathë, këpucë, ia ka mbathë lopëve, kuajve, edhe ka punu... e ka pasë dyqanin afër shtëpisë. Ka pasë myshteri shumë. Ka pasë shoqëri shumë, ka pasë qef me u shoqëru, besa me të ri e me të vjetër e me të gjithë i ka shku muhabeti. Kemi qenë familje e madhe, baba i ka pasë gjashtë vllazër e tri motra edhe ka qenë vllau i katërt në familje. Gjyshi ka qenë në luftë, kur është bo Lufta e Kitkës atje kundër ushtrisë serbe-maqedone.

Axha i madh i ka mbajtur shtatë vjet, ka qenë ushtarë. Niherë ka qenë ushtarë i Kralit i Mbretit të Serbisë, ka qenë në gardën e mbretit. Pastaj, kur ka ra, domethonë kur e ka pushtu Gjermania Serbinë, ish Jugosllavinë, ai osht' kthi prej Beogradit në kamë atëherë. Kanë dezertu, u kthi në shpi, se e kanë marrë si SS¹ gjermanët edhe kështu që, domethonë i ka bo shtatë vjet. Gjyshi ka shku në luftë, axha i dyti ka qenë si student në Egjipt ka shku ka studiu e axha tjetër edhe ai shkon në luftë me brigada shqiptare e shpija, domethonë i mbetet babës tim. Sa vjet i ka pasë? 14 ose 16, s'di.

Kur osht' kthi gjyshi prej luftës i ka thanë, "Ti boll mirë p'e menaxhojshe shpinë. Maje ti". Edhe ai ka qenë si zot shpije. Ai i ka pasë për barrë me u kujdesë për të hyrat e të dalat e tonë ata vllazër e motra me i martu, e me ju bo shpija, me ju bo... domethonë baba osht' kujdesë ma së shumti. Ka qenë

¹ *Schutzstaffel* (e përkëthyer si Skuadra e Mbrojtjes ose trupat mbrojtës), i shkurtuar SS ishte një organizatë kryesore paraushtarake nën Adolf Hitlerin dhe Partisë Naziste në Gjermaninë Naziste, dhe më vonë në të gjithë Evropën e pushtuar nga gjermanët gjatë Luftës së Dytë Botërore.

shumë punëtor i madh, ka qenë shumë i vyshëm, por ka qenë edhe arsimdashës. Ai për veti s'ka mund atëherë të shkojë në shkollë se i ka pasë vetëm katër vjet shkollë të kryme në serbisht në fshatin Kmetovc, po vllëzërit e vet Ibrahimin edhe Sabitin i ka çu në shkollë. Ka thanë, "Shkoni, shkollohuni!" E ky ka punu si, si nallban².

Anita Susuri: E çfarë familje ka qenë kjo e juja? Se domethonë nuk po duket si ni familje rëndomtë. A kanë qenë të kamur? A kanë qenë të pasur?

Hidajete Shabani Dërmaku: Po kanë qenë ni familje mesatare. Jo shumë të kamur, po s'kanë qenë edhe të varfur. Se domethonë edhe ai stërgjyshi, unë... edhe ai ka pasë do djem... në të vërtetë ai veç dy djem i ka, ju kanë plakë. Veç dy djem ju kanë plakë e tjetër i kanë vdek. Njënin e kish pasë në medrese në Dobërçan atëherë përpara, Mirash po i thojnë tash. Ai kish studiu aty po kish pasë vdek i ri. Domethonë edhe ai gjyshi i kanë thanë, Shaban Aga. Ka qenë njeri i mençur, njeri, domethonë, s'ka qenë i varfur po ka qenë ma tepër i mençur. E kanë respektu edhe e kanë dashtë njerëzit fort.

Anita Susuri: E a e dini qysh u bo, e përmendet këtë axhën e juj që ka shku në Arabi me studiu...

Hidajete Shabani Dërmaku: Në Arabi po.

Anita Susuri: Qysh u bo kjo?

Hidajete Shabani Dërmaku: U bo se ka pasë qef ai. Ka shku në shkollë medrese me siguri ma s'pari e pastaj ka pasë qef me shku me studiu, me i vazhdu studimet. E gjyshja s'ka pasë qef me lanë me shku ka thanë, "Jo se... martohu. Me pru ni krah pune në shpi" (buzëqeshë). [Ai] Ka thanë, "Jo", thotë, "qe ku e ki Hasanin, e ki Hysenin. Martoji ata, unë po du në shkollë me shku". Edhe ka insistu me marrë lejen prej nanës të vet që me shku me studiu. Edhe shkon atje me nja dy vendas tjerë, aty kanë qenë edhe ata. Ai ka qenë shumë i ri atëherë, po pastaj ka mbetë atje. Veç njëherë ka ardhë.

Si student është kthi niherë në pushim, pastaj në atë kohë Mbreti Faruk ka qenë ai shqiptarë, me origjinë shqiptare, djali i Mehmet Ali Pashës. Edhe ai i ka pritë, se ky ka qenë oficer, nuk ka mësu për hoxhë, ka qenë oficer i Mbretit Faruk. Ai i ka pritë, domethonë, në pallat të vetin shqiptartë. Studentat shqiptarë që kanë qenë në Egjipt. Ka pasë prej Shqipërisë, ka pasë prej Kosovës. Pastaj, kur osht' bo Lufta e Dytë Botërore ni kohë të gjatë i kanë shpëputë lidhjet edhe kanë mendu që, kanë thanë a din kumeditë, atëherë s'ka pasë qysh ka tash radio, televizioni e telefonat e ku di unë. Kanë marrë vesh që... (qanë). Kanë mendu që s'ka mbetë asgja i kanë zhdukë shqiptarë. Ni kohë të gjatë s'ka pasë kurfare kontakti me Kosovë, me... e pastaj, edhe atje bohen ndryshimet në Egjipt. Ai kur vjen Naseri ata e burgosin këtë axhën. E kishin pasë burgosë edhe e kanë dënu me...

² Turk: *nallbant*, quheshin zanatlinjtë që merreshin me zejen e punimit të patkojve dhe vendosjes së tyre në shtazë shtëpiake. Emërtimi rrjedh nga termi në gjuhën turke *nal* që ka kuptimin e patkoit.

Anita Susuri: Kta prej Arabisë a?

Hidajete Shabani Dërmaku: Në Egjipt. Po de, qata të Arabisë e kanë burgosë. Më duket e kishin pasë dënu, kta nejse p'e lo se nuk jom e sigurtë që e kanë dënu me vdekje. Nuk e di, ka shpëtu edhe ka shku në Siri. Ni sirian e ka majtë msheft në shpi të vet me vjet. Pastaj atje e kanë shpallë në Arabinë Saudite ni konkurs e kanë lypë ni redaktor për lajme të gjuhës arabe edhe ai siriani i propozon thotë, "Me shku me u paraqitë". Nejse se kanë bisedu edhe me axhën tjetër, ai thotë, që paska punu edhe si msus atje. Ka qenë redaktor i Radio Gjeddës [Jeddah] ai axha atje. Ka mbetë.

Pastaj ka vu, kur kanë shku haxhitë përpara, e ka vu kontaktin. Kta gjyshi jem me marrë vesh që po shkon dikush në haxhillëk, a din, kanë shku kumeditë ku me gjetë atë njeri për m'i dhanë porosi me shku me vizitu axhën. E i vëjnë kontaktet. Edhe ai atje është martu me ni gru shqiptare. Po, e ka, osht' e Pejës. Nejse, kur shkon ni vendas i joni, besa nji ka qenë ma së pari ni i Kumanovës, Haxhi Arifi i thojshin, ai ka ardhë pastaj te na. Thojke, "Jom vllau i tetë i ju", ka ardhë rregullisht me gru, me djem e në vizita. Kanë shkëmby vizita shkaku i axhës. Në '68-ën ai është kthy për herë të parë...

Anita Susuri: A ju kujtohet, jo...

Hidajete Shabani Dërmaku: Po, 15 vjet.

Anita Susuri: Po, 15 vjet.

Hidajete Shabani Dërmaku: 15 vjet i kom pasë, hala 15 po vitin e 15 kështu. Po, po më kujtohet kur ka ardhë ai edhe krejt katundi dolën në fund të katunit me pritë. Ai ka ardhë, ka shku drejt në Gilan te halla madhe. Te shpija edhe atë, përpara s'ka pasë shumë, ai ka pasë veturën na tjetër pa vetura, send, as telefona s'kish as kurgjo. Kta krejt katundi dulën me pritë poshtë ai, "Jo, po rri në Gilan", se kish udhëtu shumë gjatë prej Arabisë e donte me bujtë atje në Gilan te halla. Kta i thanë, "Jo, duhesh me ardhë se po të presin të gjithë".

Më kujtohet kur ka ardhë. Krejt floktë e bardha (qanë). E thotë gruja axhës, tha, "Muharrem Aga", se veç ata e kish lanë vllau i madh i martum kta tjetër krejt kanë qenë ma të ri, thotë, "A je merzitë?" Thotë, "Të kallxojnë", tha, "këto" {prek flokët me duar}. Krejt floktë e bardha. Ai ka pasë nejt pesë javë, e natë e ditë kanë ardhë njerëz me vizitu prej tona anëve të Kosovës.

Anita Susuri: Fillimisht kur ka shku, qysh ka shku ai? A ka pasë ndonjë transport me tren a qysh ka shku?

Hidajete Shabani Dërmaku: Se di po sigurisht ka pasë diçka. Atëherë prej Shkupit ka pasë tren, atëherë s'ka pasë prej Kosovës nuk ka pasë. Nuk e di hiç, nuk e di me siguri. A kanë shku anej nëpër Greqi me anije a nuk e di, s'e kemi bisedu. Hera e parë tash... me siguri axha e din. Unë bisedova, isha

të shtunën në Gilan. Ai ka bo 90 vjet axha, osht' profesor i gjuhës edhe letërsisë shqipe, e ka shumë... e mendova, bile, ndoshta kishit mujtë edhe me të me bo ni bisedë.

Anita Susuri: Po patjetër, kemi pasë në plan edhe kemi plan.

Hidajete Shabani Dërmaku: Me shku me bisedu ai i din ma mirë këto. Unë për veti kam qenë shumë e re atëherë dhe atij s'i ka dalë kohë shumë me nejtë me, se tanë kohën në odë ka qenë. Vishin burrat me pa prej tona anëve, me bisedu, kishin qef me nejt me to. Ka qenë njeri i ngritun, njeri i mençur. Me iniciativën e tij kaq shumë ka bisedu atëherë, për herë të parë i ka bind ata në Gilan të arsimit me hapë ni shkollë. Jo, klasë vetëm për vajza në Normale të Gjilanit. Për me i nxitë njerëzit që me i leju femnat me shku në shkollë. Me pasë pak ma shumë [vajza të arsimuara], e kanë pasë bo ni klasë. Nejse, pastaj, ma vonë janë përzi prapë (qeshë). Në fillim ka qenë si iniciativë.

Unë atëherë kom pasë të kryme tetë vjeçaren, qat vjet. '68-ën e kom pasë kry tetë vjeçaren edhe besa m'ka pasë regjistru baba në Shkollën Normale edhe unë kom qenë njana prej atyne. Ndoshta se di, a janë arkivat tash, i kam aty dokumentet (qeshë). Po e kisha nanën e smutë atëherë s'kishte, kta vllëzërit ishin t'ri, t'vegjël s'kish kush m'u kujdesë për ta. E m'u dashtë me nejt n'shpi, mos me shku n'shkollë.

Anita Susuri: E ju si fmi, qysh ju kujtohet kjo dinamika e familjes? Organizimi në familjen e ju? Qysh ka qenë shpija? Qysh e kujtoni krejt këto?

Hidajete Shabani Dërmaku: Shpijen, e kujtoj, kto kujtime të mira janë. Kemi qenë, si thatë, edhe ju familje jo shumë e pasur, por edhe e varfur s'kemi qenë. Nuk kemi vujtë për kurgjo, kemi pasë tona për çka ka pasë atëherë. Domethonë, bujqësi kemi punu kemi mbjellë duhan, duhan, po. Kah dhetë mijë fije duhan i mbjellshim e domethonë prej pranverës e deri në pranverën tjetër kemi qenë të zanun t'u u marrë me duhan. Njëherë me mbjellë ato fidanet, m'i ujitë, m'i herrë, m'i mbjellë duhanin me prashitë, me ujitë, me thy, me ngjitë varg, me... pastaj me bo kallap. Ka qenë shumë punë e randë.

Anita Susuri: E keni bo duhanin kështu tamon si duhan, a keni shitë kështu si refuz që thojnë?

Hidajete Shabani Dërmaku: Jo, çka osht' refuz s'e di. Jo, na e kemi mbjellë. E kena mbjellë prej farave.

Anita Susuri: Po.

Hidajete Shabani Dërmaku: Po. Edhe e kemi bo kallap, harar i thojshin ka qenë kështu ni metër i bojshin, ai axha i madh i bojke. Gjithë dimrin ai ka bo kallap. Na i kemi bo kallap, ai ka bo harartë edhe i çojshin. Ka qenë ka qenë kombinati i duhanit në Gilan, i çojshin atje. Kur i çojshin ata i nxjerrshin fije kështu që me vlerësu. Ta bojshin, ka qenë...

Anita Susuri: Domethonë, e keni shitë veç si bimë ashtu jo si cigare?

Hidajete Shabani Dërmaku: Jo, jo cigare jo.

Anita Susuri: Jo të mbështjellta.

Hidajete Shabani Dërmaku: Po çfarë të mbështjellta cigare, ata i kanë bo në kombinat atje, na duhanin e kemi bo. Po duhanin. Prej, domethonë, prej rrajës e deri te fletat kështu i palojsim. E me bo me kalu mos me i bo barabartë ta kthejke axha. Thojke, “S’e ke bo mirë”. E me i përzi fletat, m’i nda kah pesë durë i ndajshim, pesë kallapa, pesë rende këtu të mira, orta [mesatarisht] të mira edhe kështu me madhësi edhe po. Ka qenë... baba ka punu shumë.

Kta kanë qenë kallabllak, po ma shumë bile kesh t’u mendu, se kta që kanë shku në shkollë nuk kanë punu punë të bujqësisë atëherë. Baba ka punu në dyqan, ka pasë... vishin njerëzit me mathë e ma shumë veresi. E shpesh herë edhe me argat e kanë la borxhin. Kanë ardhë kur osht’, kur ka qenë vera kanë ardhë, kanë korrë, kanë prashitë, kanë korrë grunë. E domethonë baba ka punu ma së shumti (qeshë).

Anita Susuri: A ju kujtohet nana?

Hidajete Shabani Dërmaku: Nana.

Anita Susuri: Po mendoj, ju kujtohet sigurisht, po qysh ka qenë?

Hidajete Shabani Dërmaku: Nana ka qenë shumë e urtë (qanë). Punëtore shumë. Ajo s’ka ditë me ecë, ka nga, ka vrapu. Ajo s’ka ecë, po ka nga, ka qenë tepër, shumë e, me ju shërby të gjithëve. E urtë e s’ka pasë fjalë kurrë ajo me kërkond hiç.

Anita Susuri: E qysh ka qenë, atëherë shpija qysh osht’ mbajtë? Puntë e shpisë? Si kanë qenë renet?

Hidajete Shabani Dërmaku: Renet, puntë e shpisë, po, puntë e shpisë gratë i kanë bo. Domethonë me gatu, me la, me fshi, teshat, teshat m’i la në dorë, bukën me gatu vet, me pjekë. Verës i kanë gatu, kanë pjekë me saç, e dimrit tani në shporet kështu, shporet të druve. E teshat m’i la me dorë. Deri vonë nana i ka la në dorë, ka thanë, “Unë i laj ma mirë se maqina”. E patëm ble, pat’ ble baba ni maqinë, “Jo, se s’i lanë maqina mirë sikur unë” (qeshë).

Anita Susuri: E brenda shpisë, keni jetu familja e juv po mendoj, a keni pasë edhe tjetër mixhë që ka jetu me juve, po më duket jo?

Hidajete Shabani Dërmaku: Qysh jo more.

Anita Susuri: A po?

Hidajete Shabani Dërmaku: Deri '68-ën kemi qenë bashkë.

Anita Susuri: Bashkësi.

Hidajete Shabani Dërmaku: Po. Ky mixha, ky Ibrahim, profesori, ai ka pasë dalë ma herët prej katundit. Ka jetu në Gjilan. Niherë ka pasë banesë, pastaj e boni edhe shpijen e vet. E kta tjetër kena jetu krejt bashkë. Ajo grua e axhës e madhja, ajo e ka pasë baçicë [Srb.: grua qe merret me bagëti], i thojshin baçicë m'i mjelë loptë, me tundë, me tundë tomlin, e m'u kujdesë kështu. Kto gratë tjerat kanë gatu. U dashtë me sitë miellin, e kanë mblu miellin përpara me sitë, me thasë. Kemi qenë kallabllak, bukë gjithë ditën. Si jemi çu në mëngjes herët me i shti buktë kur mas dreke vonë ka dalë rendi me shku m'i kqyrë fmijen, a me kqyrë dhomën. Kanë punu shumë. E unë e vogël kam qenë, unë dojsha m'i nimu nanës kah pak, me ia fshi dhomën (qeshë).

Anita Susuri: Cili fmi me radhë keni qenë ju?

Hidajete Shabani Dërmaku: E para.

Anita Susuri: Ju jeni ma e madhja?

Hidajete Shabani Dërmaku: Po, ma e madhja jom unë.

Anita Susuri: Edhe sa fmi tjerë janë pas juve?

Hidajete Shabani Dërmaku: Edhe pesë. Janë katër vllazën, tani motra është e fundit. Unë jom e madhja. Bile e ka pasë nana edhe ni vlla [fmi], ka jetu veç ni muj ditë ai, po. Pesë. Katër vllazër e dy motra, gjashtë. Po kanë qenë edhe gratë e axhëve. Unë, për veti, i kom dashtë shumë gratë e axhëve. Ato e kanë pasë magjën me rend, këto nana, tezja edhe pastaj ma vonë kur ka ardhë edhe grua axhës tjetër, tri. E ka pasë me rend me gatu, rendin e magjës. Po i kanë ndihmu njana-tjetrës se s'kanë mujtë me i ardhë rreth. Se, merre me mend, kur ka ardhë pranvera ka qenë pak ma lehtë, kanë lavru, e kanë mbjellë misrin, e ato po... si u bo misri e duhani kah dy, tre parë argat i kena pasë.

Dy-tre parë argatë. Argatë me prashitë misrin, argatë me, besa edhe bojshin tulla atëherë, me bo shpija se vllazën kallabllak u dashtë, mendojshin që m'u nga [përngja] najherë. Me bo qerpiq i thojshin përpara se as tulla jo, qerpiq. Magjuptë³ vishin me gra e me fmi, bojshin qerpiqtë. Po u dashke bukë me ju dhanë, me ju gatu gratë bukë edhe atyne. E kur i merrshim edhe argatë me ngjitë duhan, me ngjitë

³ Term derogativ për romët.

dorë, jemi bo varg. Se di a e dini, s'muni me marrë me mend, qysh ka qenë. Shkojshin e merrshin e mushin ni kerr të madh me duhan edhe e bishin e shprazëshin aty. Veç u deshke me ngjitë me gjilpona me i bo varg pejtë e tani me i shtri në muri për me u terë.

E i merrshim magjupet me na ndihmu me thy duhanin, fletat, gjethet edhe me ngjitë vargjët. Edhe atyne u dashke me ju dhanë, ato me gjithë fmi vishin. Me ju bo bukë edhe atyne gratë tonat. Plus hallat kanë qenë në Gilan, si u bojke vera që u lshojshin pushimet fmitë e tyre kanë nejtë në katun te na. Aty i kemi pasë. Edhe atyne u dashtë me ju bo bukë. Plus gjyshi ka qenë në odë, aty ka nejt ku ka djem e nuse kallabllak ka edhe mysafirë ma shumë. Edhe plus mas babgjyshit vishin miqtë edhe çikat e veta me vizitu edhe, po edhe miqtë tjerë edhe atyne u dashke bukë me ju bo. Kush me ju bo? Jo si sot që shkojnë blejnë, u dashke gratë me ju gatu.

Anita Susuri: Deshta me ju pytë edhe për shpinë e ju, se e di që është shumë e vjetër. Kush e ka bo atë shpi edhe qysh është dokë, nëse mundeni me na përshkru?

Hidajete Shabani Dërmaku: Shpijën e ka bo stërgjyshi jonë Shabani, baba i babgjyshit tonë. Ai e kish pasë... nejtë, kallxojnë ata sa e kanë, sa lira i ka dhanë për atë shpi e sa kanë punu. Edhe kur janë nda me vllaun e vet, ka thanë, "Unë... ti zgjedh çka të dush" [i ka thanë] vllaun të vet, "une shpijen du me pasë për veti", atë shpi se e ka bo për qefi të vet. Më duket që ai e ka bo, s'pe di tash. E i kom do fotografi, Muhameri e ka rregullu tash e ka bo shumë mirë. Ka qenë në televizion, s'e di a e keni pa?

Anita Susuri: Po, po.

Hidajete Shabani Dërmaku: Po, e ka rregullu shumë mirë. Pak a shumë ia ka kthi origjinalitetin po edhe e ka ndryshu pak se nuk osht' qysh ka qenë përpara. Përpara thojnë, se unë, i ka pasë shtazët i kanë majtë në katin përdhesë e në katin e dytë, domethonë në kat kanë jetu vet. Pastaj, kur u rritë familja, u dashtë me i lshu dhomat. Atëherë s'ka pasë shumë mundësi me bo shpija si tash që po i bojnë. E kanë prishë ahrin e kanë bo dhomë (qeshë). Ia kanë zvogëlu terenin shtazëve. E mirë ka qenë shpija me dritare të mdhaja edhe sot i ka qato.

Besa, unë kisha pasë haru se ky axha po m'thotë, "Aga Hysen", tha, "e ka ndrru shpijen atëherë ia ka pasë hjekë", a din, ia ka pasë hjekë ato dritaret e vjetra. Pati vnu dritare kështu sikur, jo si kto, kto të pllantikës qitash, po të drunit e pak ma ndryshe. E kisha haru unë, se tek i kanë ndryshu Muhameri që i ka qit' ato dritaret origjinal qysh kanë qenë ato të përparshmet. Domethonë, dhomën ku kena pasë na, kemi, ne kemi nejtë në atë dhomën, domethonë kemi lindë në atë dhomën ku ka nejt Shaban Aga.

Ai i ka pasë tri dritare në ballë dhe njo për anash, domethonë katër dritare. Sikur kto shpitë, do që i kom pa, do të vogla, po mendoj përpara që i bojshim me dritare qikaq të vogla {shpjegon me duar madhësinë}. Ajo i ka pasë dritaret e mdhaja. Dhoma tjetër edhe ajo i ka pasë të mdhaja edhe ato dy

dhomat tjera edhe ato të mdhaja. E pastaj thonë që ka qenë si fllanik⁴ a nuk e di ku i kanë majtë bylmetin aty poshtë aty. Edhe aty kanë qenë tri dritare, ma vonë e kanë adaptu e kanë bo si dhomë ku kemi nejtë, [dhomë] të shporetit. S'po di tash se ka ndryshu edhe unë kam ndryshu (qeshë). Kam ndryshu se kam nejtë shumë në Zvicërr.

Anita Susuri: A ka pasë kështu si ballkon si...

Hidajete Shabani Dërmaku: Po si çardak i ka pasë në katin e dytë, osht' qashtu, osht'. E poshtë e ka pasë, i thojshim, hajat. Po ka qenë, përpara ma herët, ka qenë tokë e shtrume s'ka pasë cymet. E ma vonë e shtrunë pak me cymet. Domethonë, dhoma ku kemi nejtë shporeti, si ke çelë qat' farë hajatin, po ai hajati çelë ka qenë, s'ka pasë as dyrë as kurgjo. E domethonë, si e ke çelë derën ka hi krejt ftofti mrena. Po.

Anita Susuri: E për kështu...

Hidajete Shabani Dërmaku: Me drrasa e kemi pasë të shtrume po. Atëherë me drrasa, se dikush e ka pasë tokë, me ni pjesë e kanë pasë me sanë, dikush dikushi. Jo, na, në mahallë tonen qishtu i kena pasë me drrasa ato dhomat ku kena nejtë, të shtrume me drrasa. Ma vonë i shtrunë edhe do i bonëm si shilte kishe...

Anita Susuri: Si minder.

Hidajete Shabani Dërmaku: Minder, po, shilte. Niherë shilte tana ma vonë edhe ni minder e ka pasë rregullue aga. Agë i kemi thanë babës.

Anita Susuri: A ka pasë shpija si nifarë nxemje që ka qenë si me avull, a qysh ka qenë?

Hidajete Shabani Dërmaku: Jo.

Anita Susuri: Shpijat e vjetra e kanë pasë.

Hidajete Shabani Dërmaku: Nashta. Jo e jonja, jo s'e ka pasë, shporetin e ka pasë. Jo more çfarë nxemje (qeshë). Jemi mërdhi (qeshë). Veç qaty te shporeti kemi kallë zjerm e nëpër dhoma tjera rrallë ka bo vaki. Ka pasë kube, do kube ju thojshin. S'pe di se tash po ju thojnë kamina kta edhe janë konë kube e llastres a teneqe, a s'e di çka ka qenë ai materiali se krejt të ndryshkta janë konë. Po u nxejke shpejt ajo. Kur i shtishe dru pak ma shumë ajo u bojke zhig, a p'e din çka osht' zhigi?

Anita Susuri: Jo.

⁴ Pjesë e ftohtë e shtëpisë ku është ruajtur ushqimi që të mos prishet.

Hidajete Shabani Dërmaku: Jo a? S'po di qysh me thonë, kur nxehet hekuri që skuqet krejt. Po, kuq. E na i thojshim zhig u bo, s'e di tashti a serbisht a çka osht', nuk e di.

Anita Susuri: Jo, s'pe di as unë. Deshta me të pytë tash për pjesën jashtë shpisë, a keni pasë tjera obligime?

Hidajete Shabani Dërmaku: Po, normal, kemi pasë hamarin ku kemi majtë grunin, kemi pasë koshin ku osht' majtë kallamoqi se kto tramaktë, a din? A po më kupton?

Anita Susuri: Po, veç shpjegoje ndoshta dikush nuk e din.

Hidajete Shabani Dërmaku: Tramaktë janë, sikur kto, shtalbat që po i bleni në qytet qashtu. I kena marrë kur ka ardhë vjeshta e korrshin misrin ose kallamoqin e tana e çojshin në shpi edhe i dajshin ato, i çërojshim, e xhvoshqim[qerojshim] misrin, i dajshim veç e i shtishim në kosh. Ai koshi ka qenë me thupra i marum e osht' ajrosë nuk i ka lonë me u mykë mistrin. I qitshin në kosh mos me nxon shumë e kto farë tallën ia kanë qitë shtazve i kanë hangër. Hamarin grunë, veç grunin e kena majtë. Tani e kena pasë ahrin, ku kanë nejtë loptë e bullicat. S'kena pasë na shumë bullica. Dhenë në torishtë, i thojnë, ka pasë. Edhe ni odë e kemi pasë veç.

Anita Susuri: E kjo oda ka qenë si për mysafirtë apo?

Hidajete Shabani Dërmaku: Po, për mysafirtë. Bile, s'di në cilin vit e ka pasë, i ka pasë, gjyshi ju ka thonë djemve të vet, "Me ma bo odën se po vjen Muharremi prej Arabisë", atë axhën e pritke. Tani e kanë ndërtu se me u zgjeru pak se kallabllak. Tani si u bo oda axha nuk erdh, gjyshi ka nejtë atje në odë s'ka nejt ma ktu me neve. Po mendoj, me fmi, se djemtë e vet kanë nejtë me babën e vet në odë atje kanë hangër bukë mas darke. Veç kanë shku nëpër dhoma të veta.

Anita Susuri: Domethonë, burrat kanë nejtë ndamas?

Hidajete Shabani Dërmaku: Ndamas po. A përpara ma herët, mu më kujtohet gjyshi kur ka nejtë aty në dhomë te shporetit. Qaty ku rrishim qaty. Më kujtohet, e mbaj mend, po masanej kur u bo oda ma s'ka nejtë me neve, ka nejtë atje.

Anita Susuri: Çka ka pasë tjetër në atë shpi? A ka pasë asi dollapa...

Hidajete Shabani Dërmaku: Po, po, po dollapat janë ata. S'i ka prishë asnjë, s'i kena prishë. Jo, yklyqet ato edhe ka pasë, po përpara ma herët më kujtohet ka qenë si shprazëtinë aty ndërmjet dhomave, ajo kish qenë në fund atje tualeti, WC. Se s'kanë dalë përpara natën, kur u bo terr e ka pasë ai te shkalltë ni kapak e kanë mshelë atë kapakin e kanë lshu mos me mujtë me hy dikush prej poshtit. Ajo WC-ja ka qenë në fund e...

Anita Susuri: Mrena në shpi a?

Hidajete Shabani Dërmaku: Po de, mrena nashta pak si jashtë. Unë nuk e di, nuk e mbaj mend, veç kanë kallxu që ka qenë si WC aty. Tani ma vonë e kanë mbyllë atë pjesën aty dhe e kanë bo si fllanik. Fllanik a p'e din çka osht?

Anita Susuri: Po, me i majtë fllad senet.

Hidajete Shabani Dërmaku: Fllanik, xharranik. Po de, djath e turrshija. Eh, qaty i kena majtë.

Anita Susuri: Sigurisht kanë pasë edhe hamamxhik?

Hidajete Shabani Dërmaku: Po de, hamamxhiku. Nalu, dhoma ka qenë kështu e ktu poshtë hamamxhiku tani edhe ikliki, iklik i kemi thonë na atyne...

Anita Susuri: Iklik?

Hidajete Shabani Dërmaku: Po, iklik, dollap ku i kemi majtë dyshekat, jorganat, naj teshë. Poshtë në iklik ka qenë një, aty kanë majtë dru a boqa për me dhezë zjarmin. Kanë dhezë zjerm. Po, po secila dhomë e ka pasë hamamxhikun e vet, domethonë banjon, si banjo.

Pjesa e Dytë

Anita Susuri: E shkollën a e keni pasë në Përlepnice, a u dashtë me...

Hidajete Shabani Dërmaku: Po. Po, po. Unë po e ata ma herët, baba jem, ka shku me ni katun tjetër në Kemetovc, nuk e di a po i thojnë Kemetovc tash a jo. Edhe serbisht e ka kry shkollën. A na tetë vjeçarja ka qenë si qajo shkolla që e pat' në të fotografinë, po. Ka qenë, me gurë e bame. E në '68-ën e kanë pasë nisë e patën bo këtë shkollën e re. Objektin e ri.

Anita Susuri: Çka ju kujtohet prej qasaj periudhe të shkollës?

Hidajete Shabani Dërmaku: Qysh s'më kujtohet ditën e parë të shkollës, kurrë në jetë s'e harroj, kurrë s'e harroj hiç. Më kujtohet.

Anita Susuri: Qysh ka qenë?

Hidajete Shabani Dërmaku: Tha djali axhës tha, “Ti ndëgjo, unë po shkoj në shkollë, ti pak ma vonë hajde te shkolla të çoj te msusi” (qeshë). E nana u dashke me m’lanë ma s’pari, tana me shku (qeshë). Unë çohem edhe shkoj vet, shkoj vet qysh më tha ai djali i axhës, Faruku. Shkova atje, u afrova afër shkollës, ai dulë më mori e më çoi te mësusi Reshat. Ka qenë shumë mësues i mirë. E nuk e harroj kurrë. Të nesërmen shkova, kur shkova më lajti nana. Ma veshi ni fustan ma të lamë, ma të mirë. E kur shkova unë u mshefa mas ni therrës (qeshë). E pashë msusin që është në oborr e u mshefa mas ni therrës, ai m’pa. Na ka sjellë [edukuar] shumë, na ka deshtë shumë, prej kujtimeve ma të mira.

Anita Susuri: Tetë vjeçaren e keni kry, a veç katër vjet keni pasë në qat’ shkollë?

Hidajete Shabani Dërmaku: Jo, tetë vjeçaren.

Anita Susuri: Tetë vjeçaren.

Hidajete Shabani Dërmaku: Po, po, tetë vjeçare ka qenë. I kena pasë mësustë e mirë, kanë qenë shumë entuziastë atëherë, shumë. Edhe shumë entuziastë, kanë punu shumë, kanë pasë vullnet, kanë organizu a për festa mbajshin shfaqje sende. E tash nuk e di, edhe tash po mbajnë. Isha bile sivjet për ditën e shkollës atje në katun.

Anita Susuri: E ju a keni majtë ditë shkollës? Ju a keni shku për shembull?

Hidajete Shabani Dërmaku: Na ditë të shkollës, shkolla jonë s’ka pasë emër hiç deri në ‘68-ën...

Anita Susuri: Po a?

Hidajete Shabani Dërmaku: Po, hiç s’ka pasë, s’ka pasë ditë shkollës. Por mbajshim [program për] festa si 29 Nandori, Ditën e Republikës [të Jugosllavisë]. Po, 29 Nandori, për 1 Majin, 8 Marsin atëherë s’e ka festu kërkush as 7 Marsin, kërkush. S’ka pasë shumë festa, po për 29 Nandor edhe për 1 Maj. Bile, na shtishin me dalë nëpër katun, i thojshin flakadan, a nuk e di. I bojshin, qitshin pak hi me ni kuti të konzervës a s’di çka aty i qitshin pak hi, do gaz edhe e dhezshin, a din, me bo flaka, me dalë nëpër katun.

Anita Susuri: A u kanë ajo si dita e rinisë diçka që i thojshin?

Hidajete Shabani Dërmaku: Jo e 1 Majit, ka qenë dita e 1 Majit. Ajo ma vonë për Titon s’më kujtohet. Nuk më kujtohet që kena bo diçka për 25 Maj, hiç nuk më bjen në mend.

Anita Susuri: Thashë mos është qajo.

Hidajete Shabani Dërmaku: Jo, jo, për 1 Maj. Dita e 1 Majit, dilshin atje i dhezshin zjarret, po përmi katund në kodër edhe njo me ni kodër tjetër. Në kodrën tjetër u shtyjshin mahalla me mahallë cila po e bon zjermin ma të madh.

Anita Susuri: Deshta me pytë për kto festat, për shembull bajramat, ramazanat qysh kanë qenë? A janë festu?

Hidajete Shabani Dërmaku: Qysh jo, po, po. Kur kemi qenë të vegjël ka qenë pak ma ndryshe. Tani dikur pak i dul, u zbeh, u zbeh. Po, po. Kur bojshin ramazan kanë ninu. Edhe unë e vogël jom konë, ni kashore u untosha shumë po kisha qef me ninu (qeshë) ninojsha. E gjithë ditën aq u untojsha. U untojsha shumë, nuk e di, nuk e nisha shumë urinë po u bojsha shumë nervoz. Edhe sot me ninu bohem shumë nervoz. Nuk e ni urinë, kshtu nevojën as me pi ujë as me honger bukë po bohem shumë nervoz. E tash s'ninoj hiç (qeshë).

Anita Susuri: E qysh kanë qenë bajramet për shembull?

Hidajete Shabani Dërmaku: Bajramet, e, bajramet. Atëherë prejshin pak naj sen. Për Bajram të Madh e prejshin ni quran, biban a qysh m'i thonë? Gjeldeti kta në Shqipni po i thojnë. Na i kemi thanë quran. E e blejshin ma herët edhe e ushqejshin me brum të misrit edhe ia jepshin me u maj kishe edhe e prejshin. E për Bajram të Vogël prejshin kurban, domethonë naj dash, a naj ku e di une kom harru. E natën e bajramit na i ngjyrosshin me kanë gishtat. Edhe kur ishte vajza e axhës, [ajo] ish pa martu, ajo na i ngjyroske edhe mu edhe vajzës të axhës, motrës të vet. Na i ngjyroske gishtat, na lyjke me kanë, tana flejshim me to gjithë natën të nesrit i lajshim dur të. E kish, gjithë natën s'mujsha me flejtë (qeshë).

Anita Susuri: E kjo kana a u ble?

Hidajete Shabani Dërmaku: U ble, u ble. Prej Turqisë e kanë pru, nuk e di. Prej Turqisë e merrshin, e blejshin. Na i kemi pasë edhe do akraba atje në Turqi e kur shkojke dikush ose që vishin na çojshin kanë.

Anita Susuri: A ju kujtohet edhe si ma fmi kur keni qenë vitet, fund vitet e '50-ta, '60-ta fillimi, ka qenë koha e Rankoviqit edhe ka qenë ni kohë e keqe...

Hidajete Shabani Dërmaku: Shumë.

Anita Susuri: A ju kujtohet juve?

Hidajete Shabani Dërmaku: Po...

Anita Susuri: Mbledhja e armëve, për shembull?

Hidajete Shabani Dërmaku: Jo, jo. Atëherë '55-tën u konë mbledhja e armëve, mu s'më kujtohet se i kom pasë veç dy vjet. Por më kujtohet kur, se kur thashë që bojshim kallap të duhanit. E u ulshin aty me bo kallap, ai axha e bojke hararin i palojke ato, kto farë, kallapit s'po di qysh me thonë, fletat i bojshim nisoj ia jepshim atij ai i palojke, i bojke ni metër edhe i shtypke për me zanë ma shumë. E bojshin llaf, tani kallxojshin gratë. Kallxojshin gratë çka kanë përjetue e qysh ju kanë kujtu. Po edhe axha më kujtohet që kallxojke.

Atë axhën e kanë rreh atëherë në atë aksionin e armëve, se i kanë lypë pushkë axhës të madh. E ni kusheri tjetër, ata e kanë majtë, ai djalë i vetëm ka qenë, e kanë majtë gjithë natën në kmishë e në done përjashta edhe në dimër. E kështu farë skena. Tani kallxojshin asaj grujes të axhës qysh ia kanë vra vllaun. Mas '45-ten e kanë marrë, e kanë torturu, e kanë mundu, kumeditë edhe ka vdekë. Qat' vlla e ka pasë, babën nuk e ka njoftë hiç, se ka shku ushtar edhe i ka vdekë në ushtri. E qat', kta, kanë qenë dy motra edhe ni vlla. Gjyshi edhe gjyshja i kanë rritë. Ma shumë e kanë përmend gjyshen, sesa nanën e vet. Nuk e di çka ka ndodhë me nanën e tyne, kurrë s'e kemi përmend.

E kallxojke pastaj gjyshi i vet, [ai] ka qenë ktu prej Gilanit se e Malishevës edhe ajo ka qenë, afër Gilanit, osht' ulë te kroni me pi ujë me pushu dhe vjen ni katundar i thotë, "O mixha Metë, mixha Metë", thotë, "Çka?" Thotë, "A e din", thotë, "qysh ka vdekë Hyseni?" Thotë, "Jo", thotë, "Ja kanë vnu ni guri në gjyks, e kanë torturu, i kanë vnu guri në gjyks atij". I kish pasë thanë atij, "M'u ka dokë që m'u ka këputë diçka", edhe ka shku në shpi ka vdekë. Domethonë, qisi farë kujtime.

Pastaj, kallxojke nana e tezja, kallxojshin ato kur ia kanë marrë bukën. I kanë mbledhë tepricat. Kanë shku i kanë marrë miellin në magje s'ju kanë lonë kurgjo e tepricat. Merre me mend! E qysh asaj, qysh kanë jetu e qysh kanë mujtë me kalu. Kallxojke, kanë pasë mullinin, a din, edhe çka kanë mbetë, çka ka mujtë me ju dhanë dikush diçka ato diçka ujem ju thojshin. Ju kanë thonë ujem atij. E ke çu drithin me blu, për me ta blu drithin, u dashtë me lanë diçka pak miell. E me qat' farë ujemin 40 vetë në shpi me metë gjallë. E kanë pre kaun me hangër mish në vend të bukës. S'kanë pasë bukë me hangër.

Kallxojshin kur aty, kur ju kanë qitë, ju kanë lonë rojen te dera e shpisë me kqyrë a po kallin zjerm a jo. A po gatujnë, si të gatujnë e kanë mshef miellin najkund, grunin. S'i kanë lonë tepricat. Se... e baba jem ka qenë i organizum si komunist atëherë. Ka qenë edhe i zoti, po kur i ka pa çka po ndodhë e çka po... baba s'e ka përmend, po axha tjetër ka kallxu. Ai s'ka mujtë edhe ka hjekë dorë prej partisë.

Anita Susuri: E për babën e juj në dyqan a ka pasë ai naj argat? A ka pasë ndonjë ndihmës, a ka shku dikush prej fmive edhe me i ndihmu?

Hidajete Shabani Dërmaku: Ai në fillim, domethonë, ma herët e ka pasë axhën e vogël, i ka nimu edhe ni kusheri. E pastaj ata, ai kusherini ka shku e ka kry [Shkollën] Normalen u bo mësus edhe ky

axha nuk ka pasë qef me punu aty. E kta djemtë i kanë nimu, Naseri vllau i madh i ka ndihmu babës edhe Muhameri.

Anita Susuri: A keni shku ju ndonjëherë aty në dyqan?

Hidajete Shabani Dërmaku: Në dyqan, po. Na ka marrë baba. Na ka marrë me na hjekë prej shpisë, se unë s'kom bo kurgjo, kom nejtë qaty në qosh. Ka pasë nifarë vendi aty m'u ulë edhe ku i ka ndreqë ata patojktë për lopë, se për loptë i ka bo vet ky ato. Ka ble llastër, i ka pre, i ka shpu edhe tani ia merrke masën. E di mu më kujtohet kur mathke, kom nejtë aty në dyqan shumë. Mu më ka marrë veç me më hjekë prej shpisë, a din, me ia lehtësu nanës pak. Baba u kanë shumë... më kujtohet edhe thojnë, kur ka ra tifoja, ju kish pasë ra atëherë mas luftës. Edhe janë smu krejt, veç ky s'ka qenë i smutë baba jem. E ky ka gatu edhe ni gru e kusherinit edhe ajo ju ka pru me hongër.

Anita Susuri: A kanë pshtu?

Hidajete Shabani Dërmaku: Ju ka pru ju ka lonë. A?

Anita Susuri: A kanë pshtu?

Hidajete Shabani Dërmaku: Po, po. Jo s'ka vdekë kërkush. S'ka vdekë kërkush veç ajo grua e axhës ka qenë shumë shumë keq. Shumë e smutë. E për kta tjetër nuk e di, për kta s'më kujtohet qysh kanë qenë. Veç ajo thojnë që ka qenë shumë e smutë. Edhe atëherë nuk e di a ka pasë edhe naj gru tjetër në shpi a jo, a baba ka gatu edhe ka gatu ai.

Anita Susuri: E çfarë dyqani ka qenë ky i babës të juj? Qysh është dokë dyqani?

Hidajete Shabani Dërmaku: (Qeshë) Qysh ka me u dokë, dyqan ku i bijnë loptë e bullicat e kuajt e... era bagla (qeshë). E ka pasë ni fallak a nuk e di, për me i... kur i kanë rrxu loptë për m'i mathë, u dashtë me i rrxue, e ia vnojshin nifarë të drunit ka qenë e gjatë, ia vnojshin kamtë e para edhe të mramta ia lidhshin për atë fallakun. E tana ato kamtë përpjetë me ia gdhendë ato, me ia hjekë ato qysh i thojnë asaj...

Anita Susuri: Si thojtë.

Hidajete Shabani Dërmaku: Si thundra se s'mu kujtu. Me ia pastru ma së pari i ka pasë dy, më doket dy janë konë. E qishtu kanë qenë ato si e hekurit e mprehtë e ktu tana ni bishtë të gjatë të drunit me ia pastru ma së pari. Tana i merrke ata patkojtë ia mathke, a jonë të mdhaja, nëse janë të mdhaja i zvogëlojke edhe pak i prejke. Ka pasë gjithçka. Ka pasë mjete shumë aty. Tanaj me thuma *tak tak tak* {onomatope} me ia qëllu. Ka qenë mjeshtër i mirë, prej kumeditë ku kanë ardhë, ka pasë shumë myshteri.

Anita Susuri: Po po më doket edhe ni prej televizionit ka qenë te baba juj, a ju kujtohet juve? A keni qenë?

Hidajete Shabani Dërmaku: Unë s'kam qenë aty, kam qenë në Prishtinë studente. Po e ka dhanë vjet a nuk e di kur parvjet në televizion, "Arkivi". Ky Avdush Canaj është poet, a po e njifni ju atë?

Anita Susuri: Jo.

Hidajete Shabani Dërmaku: Poet për fmi, po, i Gilanit. Eh ai e ka bo, ka punu në televizion. E ka pasë edhe shok babën (qeshë). E ka pasë bo atë emisionin, po e kom në telefon dikund me kqyrë s'e di.

Anita Susuri: Po, po, e kemi pa. Më ra në mend me ju vetë. E deshta me ju pytë për këtë periudhen kur e keni kry shkollën...

Hidajete Shabani Dërmaku: Filllore?

Anita Susuri: Filllore, qysh ka vazhdu pastaj?

Hidajete Shabani Dërmaku: Shkollën filllore, thashë, '68-ën e kemi përfundu, e kam përfundu. Pastaj më pati regjistru baba në [Shkollë] Normale bashkë me këtë axhën. Ky ka qenë drejtor atëherë më duket i Normales. Jo s'e di, ka qenë profesor në Gilan, s'e di. E patën ardhë besa, ka pasë ardhë me më marrë tha, "Hajde!" Unë s'mujsha me lonë nanën.

Anita Susuri: Tani s'e keni vazhdu?

Hidajete Shabani Dërmaku: Kam nejtë në shpi deri, tash me të rrejtë, bile me motrën t'u bisedu tha, "Në cilin vit ke shku në fakultet?" Thashë, "Nuk e di, a '74-tën, a '75-tën. Më duket '74-'75". Ajo, "Qysh ke harru?" Thashë, "Kom harru, nuk e di pse kom harru, kom harru". Edhe kom nejtë në shpi e pastaj '74-tën m'u mbush mendja. E pashë që s'po muj me ndjetë në shpi, se kom pasë qef shumë me lexu. Bile, sot ajo vajza e axhës bon hajgare me mu, "Ti ni copë gazetë në pleh me gjetë je nalë me lexu".

Na kena pasë libra shumë se edhe baba ka pasë qef me lexu edhe ato axhat që kanë qenë njëni profesor, ai arsimtar. Kemi pasë me këto, "Jeta e Re", revista, "Përparimi", ka qenë ni revistë, ka pasë ajo ma tepër si shkencore me thanë. E kjo, "Jeta e Re", ka qenë revistë letrare. Edhe krejt ato revistat kanë dalë ni herë në mujtë, a nuk e di qysh ka qenë puna e tyre, i kemi pasë aty. Krejt i kom lexu. I lexojsha me këto, ka pasë ksi mbledhës të folklorit, Anton Qena, Lorenc Antoni, Anton Çetta a thashë?

Anita Susuri: Anton Qena thatë, po Anton Çetta.

Hidajete Shabani Dërmaku: Po, Anton Çetta, Lorenc Antoni e pata lexu edhe kta vazhdime ka qenë, “Gjarprinjtë e Gjakut”, të Adem Demaçit. E bile kur isha studente me ni shoke s’di çka po bisedojmë, tha, “Adem Demaçi ‘Gjarpërinjtë e Gjakut’”. Thashë, “Jo more, s’osht’ e ndalume. Une e kom lexu”, thashë, “e kom lexu në ‘Jetën e Re’. S’osht’ e mundur, qysh e ndalume që u botu?” E pastaj pata shku bile këtij axhës me ia lypë, “Gjarpërinjtë e Gjakut”, ktij në Gilan, profesorit. E më pat’ thanë, kurrë s’e harroj, tha, “Kryj”, tha, “ma së pari studimet. Kryj ma së pari studimet, tani i lexon këto”.

Anita Susuri: E kur ka qenë koha që ju keni kuptu për këto organizatat e mshefta, për ilegalen e librat që janë shpërnda?

Hidajete Shabani Dërmaku: A librat, librat, baba ka pasë rregullisht a. Ai ka shkru vet ma s’pari poezi edhe babën ‘63-tën ose ‘64-tën, ‘64-tën e patën marrë në burg. Erdhën na i kontrollun shpinë, bile ishim na t’u mbjellë duhon, duhon, kur erdhëm në shpi. Merre me mend, qaty sa afër ka qenë ajo ara. Kur erdhëm në shpi, s’kena marrë vesh, kishin pasë qenë UDB-a kishin kontrollu edhe e kishin marrë babën me veti. E me lexu ai merrke, i merrke këto, “Shotë Azem Galica”, Hasan Prishtinës librat çka ishin të ndaluara atëherë, në atë kohë, po. Ai i merrke me i lexu, i lexojsha edhe une (qeshë). Mu s’më ka shpëtu kurgjo.

Anita Susuri: E baba juj sa ka qëndru në burg?

Hidajete Shabani Dërmaku: Atëherë ka nejtë m’duket nja tre muj ditë. Tre muj veç e kanë {shpjegon me duar që e kanë rrahur}. Kallxojke nana atëherë...

Anita Susuri: Në Gjilan?

Hidajete Shabani Dërmaku: Në Gjilan, po. Më vjen shumë keq, nuk e di pse kurrë s’e kemi pytë as pse e kanë marrë, as çka e kanë pytë, çka i kanë bo. A nana kallxon, thotë, “Kur u çojke”, tha, “t’u u majtë për muri”, se e kishin pasë, i kanë mundu shumë atëherë. Po mu shpesh herë tash mendoj se qatëherë në ‘64-tën, pas ‘64-tës ka qenë, kto kur kanë ra në burg Adem Demaçi ‘64-ten e kanë qenë kta Rexhep Elamzi m’duket e kanë qenë... atje në Gilan ma tepër e kanë marrë se kanë dysu që ka pasë lidhje me ta. Ai lidhje ka pasë me ta, po s’ka qenë, baba s’ka qenë i organizum. Ma merr mendja, s’ka thanë asniherë se ka qenë i organizum. Libra ka marrë ose kontakte ka pasë me kta krejt, po s’po di qysh osht’ puna, kur je i organizum pagun antarësi osht’ pak ma ndryshe. E unë për veti ‘78-ën ose ‘80-ën jom organizu.

Anita Susuri: E në kohën që thatë paraprakisht ‘75-tën diku, ‘75 që keni shku në Prishtinë...

Hidajete Shabani Dërmaku: Po.

Anita Susuri: Qysh ka qenë për juve qajo kohë Prishtina? Qai ndryshim me ardhë prej fshatit në Prishtinë?

Hidajete Shabani Dërmaku: Prej fshatit në Prishtinë, po, për mue fjala student ka qenë e... s'po di, nuk di me ta përshkru. Me qenë student ka qenë për mu diçka e mrekullueshme...

Anita Susuri: Privilegj.

Hidajete Shabani Dërmaku: Privilegj. Ka qenë shumë, ka qenë privilegj për mue. E kom ndje vetën shumë mirë, shumë krenare, po edhe kom pasë shumë frikë, se krejt më thojshin, "A ti e ki vështirë, nëse kta mësojnë ni herë, ti duhesh dhetë herë ma shumë". E kom pasë atë stresin a do të muj, a do t'ia arrijë m'i kry, a me bo diçka. Ndoshta veç erdha e s'muj me bo kurgjo, a din, m'u doke tepër. M'u doke... ndoshta vet s'e kisha mendu. Por kur më thojshin, "Ti duhesh me mësu ma tepër se s'e ki shkollën e mesme, duhesh dhetë herë ma tepër me mësu". Msojsha natë e ditë, natë e ditë i përsëritsha. Veç s'kom pasë nevojë me mësu natë e ditë (qeshë). Truni i të riut është i kfejlltë, i pastërt s'ka nevojë, s'ka ngarkesa. Po ma shumë unë e kisha atë ngarkesën që kuku.

Anita Susuri: E qysh u bo kjo që shkutë?

Hidajete Shabani Dërmaku: A qysh u bo (qeshë)... ua pata shkru ni letër se më vike marre me ju thonë. Nihërë më lutën, s'deshta. Tashti, "Po shkoj". Më vike shumë keq edhe prapë më vike keq me lonë nanën. Qysh me ia nisë, qysh me ia nisë, ia pata shkru ni letër ktij axhës ktu në Gilan edhe ia kom shti në xhep tinëz (qeshë). Ai kurrë s'më ka kthy ma përgjegje. Bile, vajza e axhës e madhja e kish pasë lexu tha, "Sa mirë e kishe pasë shkru" (qeshë). E atëherë prej tetë vjeçares ndoshta s'kom ditë edhe shumë mirë me shkru po...

Në '74-tën ose '75-tën s'pe di, nejse, pata ardhë në Prishtinë se dajtë i kom pasë edhe gjyshen e gjyshin po edhe dajtë këtu, erdha. Daja erdh më murë me nejtë e s'di çka ra fjala, a din, i kallxova që kom qef me shku në shkollë. Tha, "Bash..." thashë, "Po valla, bash kom qef", thashë, "me studiu", se s'ma merrke menja me nejtë në shpi. U çu ai edhe ka shku në fakultet edhe erdh kish pasë bisedu me kta, ka pasë ai do shokë aty në fakultet në letërsi. Erdh m'i pruni tha, "Qe qikaq provime ki m'i dhonë" (qeshë).

Ma qiti listën gjuhë e anej filozofi, e psikologji e s'di çka, histori, gjeografi, frengjisht. Kur i pashë, thashë, "O more dajë", thashë, "p'e lo krejt", thashë, "për masanej po, ama ni kohë të shkurtë, për ni javë ditë unë qysh muj m'i bo kto?" A pati fillu viti, më duket ka pasë fillu. Thashë, "Nuk muj, për masanej natën e boj ditë, a tash s'muj". Tha, "Kuku", tha, "sa njersën e kom derdhë", tha, "sot kurrë hallall s'ta boj nëse s'shkon". Thashë, "Dajë, une po të kallxoj", thashë, "masanej po, a tash për tash nuk muj". E kom pasë shku besa më kanë ndihmu ata profesorat, se s'jom konë gati unë me kalu provimet.

Kom qenë shumë e lumtur, tepër e lumtur. Jom mirënjohës pafundësi dajës që m'ka regjistru. Pata shku, du me ju kallxu pak për provime. Hyna në provim në Letërsi edhe gjuhë me profesorin, ka qenë Liman Matoshi edhe Isa Bajçinca. Isa nuk nejti aty e ky Limani Matoshi më pyti për, për romanet shqiptare, “Çka ke lexu diçka?” E sende. E unë e përmenda këtë, “Afërdita” e Sterjo Spasse, “Cila”, thotë, “është ideja e romanit?” Thom, “Osht’ arsimi, arsimimi i popullit shqiptar”. E s’di çka m’bojke ai do pytje e më nxori jo bash me thanë që s’dita kurgjo. E profesor të gjeografisë e kom pasë, baba i këtij Arsim Bajramit, Arsim a qysh e ka emrin ky në PDK që ka qenë?

Anita Susuri: Po, Arsim.

Hidajete Shabani Dërmaku: Zeqerija Bajrami më duket. Jo, jo, ky ka qenë i ri...

Anita Susuri: A baba i vet.

Hidajete Shabani Dërmaku: Baba i vet, po. Ai Zeqerija Bajrami më pyti për, “Në cilin vit ka zbritë në hanë njeriu?” E disha edhe vitin edhe emrin e astronautit Neil Armstrong e ato edhe reliefin e më kujtohet ka qenë edhe Asllan Pushka pat’ ardhë aty, ma bojke {shpjegon me duar formë të rrumbullakët}, kishe reliefi. “Çka osht’ reliefi?” A din, u munojke me më ndihmu. Filozofi e psikologji i kom pasë bashkë edhe e kom pasë Hajrullah Koliqin profesor. Edhe ai m’i ka pasë bo do pytje qishtu e s’e di, më duket ka vdekë edhe ai.

Frengjisht kur shkova e kom pasë Halit, Halit Halimi më duket. Ai, “Qe”, tha, “po ta jepi, po ta boj të mundshme me u regjistru. Veç frengjishtja”, tha, “osht’ e vështirë”. Po unë, krejt ma bojshin pastaj, “Jo shko merre rusishten se frengjishtja osht’ e zorshme, osht’ profesori i keq”. Ka qenë Muhamet Kërveshi. Unë frëngjisht disha, jo e disha pak lë, la, le (qeshë) edhe rusisht nuk disha hiç edhe kambëngula edhe shkova në frëngjisht. E kom pasë dhanë edhe provimin e frëngjishtes.

Se vështirë ka qenë, s’ka qenë lehtë edhe atëherë ka qenë ma randë s’kemi pasë as materiale. Tashti... atëherë s’ke pasë. Ni fjalor e kish pasë ble djali i axhës, e kish pasë ble për veti pi Vedat Kokonës, s’ka pasë as fjalor as kurgjo. Ni libër na ka pasë thanë ky Muhamet Kërveshi me ble. Shënime kemi marrë. Po unë kam shku rregullisht nëpër ligjerata, i kom marrë shënimet. E, se e kom dashtë gjuhën frënge, e kom dashtë literaturën, letrësinë frënge, kom pasë qef.

Anita Susuri: Cilin shkrimtar e keni dashtë ma shumë?

Hidajete Shabani Dërmaku: Shkrimtarëve, francez a?

Anita Susuri: Po.

Hidajete Shabani Dërmaku: Aha, prej shkrimtarëve frëng s'po di, ka plot, Viktor Hygo. Viktor Hygon e du ma së shumti. Osht' edhe ky që e ka shkru ktu... ka qenë Russo, po Russo, besa prej Russo s'kom lexu kurgjo hala, ka qenë ajo "Kontrata sociale", a çka osht'? Po kta tjetër, po të mirë janë të gjithë. Po Hygoja është ma i miri edhe Zhyl Vern [Jules Verne] osht' i mirë. Po, s'e di, Viktor Hygon e du ma shumë. Emil Zola, tana janë, edhe kta rusët i kom dashtë shumë valla. Leo Tolstoi e atë farë...

Anita Susuri: Dostojevski?

Hidajete Shabani Dërmaku: Po, Dostojevskin. E kom lexu edhe njëherë ia kom nisë apet për së dytë, janë të mirë. A Leo Tolstoi, "Ana Karenina", "Lufta e Paqja", janë... Turgenjev, e Jesenjini janë ata Çekovi e... letërsia ruse.

Pjesa e Tretë

Anita Susuri: E kto librat, ka pasë biblioteka a ka pasë vende që i keni ble a qysh keni ardhë deri të librat?

Hidajete Shabani Dërmaku: Te librat? Na, thashë, kena pasë në shpi bajagi si shumë libra edhe i kom marrë, kur isha si studente kom marrë edhe prej axhës. Ai e ka pasë edhe ai bibliotekën. Kom pasë bibliotekën në Gilan, shkojsha edhe atje merrsha libra si studente. Se Letërsi jugosllave, Letërsi botërore e letërsia shqipe... unë e kom pasë tezën ka punu në bibliotekë të qytetit. Besa te Pallati i Rinisë ia ka pasë nisë, tani ka pasë dalë edhe atje në qytet te [biblioteka] "Hivzi Sylejmani". Po kjo biblioteka e Pallatit të Rinisë ka qenë si degë e bibliotekës, atëherë i kanë thanë "Vladimir Nazor" më doket, s'e ka pasë emrin, nuk e ka pasë emrin, qysh e ka tash? Qysh thashë?

Anita Susuri: Në Gjilan a?

Hidajete Shabani Dërmaku: Jo, ktu. Në Gjilan s'e di, s'ka pasë emër hiç.

Anita Susuri: Biblioteka Kombëtare a po? "Hivzi Sylejmani"?

Hidajete Shabani Dërmaku: "Hivzi Sylejmani". Nuk ka qenë "Hivzi Sylejmani" atëherë ka qenë më duket "Vladimir Nazor", më duket, nuk e di. Vetëm nëse...

Anita Susuri: Ka mundësi, po.

Hidajete Shabani Dërmaku: "Hivzi Sylejmani", s'po më duket që ka qenë. Ajo ka punu aty në bibliotekë, bile shkojsha kaniherë se kom pasë qef me punu në bibliotekë. Shumë... me libra.

Anita Susuri: A osht' gjallë ajo tezja juj?

Hidajete Shabani Dërmaku: Po, gjallë, ajo i ka katër muj mas meje është. Motra e nanës.

Anita Susuri: Koka e re ajo.

Hidajete Shabani Dërmaku: Po, e re.

Anita Susuri: Po, mendoj ni gjeneratë ma e re. E në këtë kohë keni jetu, thatë, te dajhtë apo?

Hidajete Shabani Dërmaku: Po, te gjyshja e gjyshi, te daja po.

Anita Susuri: Ku kanë qenë ata në Prishtinë?

Hidajete Shabani Dërmaku: Në Ulpianë janë afër shkollës "Hasan Prishtina".

Anita Susuri: A mundeni me na përshkru Prishtina qysh osht' dokë për juve n'atë kohë? Qysh ka qenë?

Hidajete Shabani Dërmaku: Prishtina, me ta thanë të drejtën, Prishtina si Prishtinë s'e kom dashtë hiç (qeshë). Mi kodra u konë palidhje. Unë e kom dashtë vendin tem, katundin Përlepnicën, ma shumë se Prishtinën. Nejse ka qenë e mirë Prishtina, ajo farë qendre. Bile, më kujtohet kur punojsha atje flitshim me kolegë atje në Zvicërr në Genevë edhe po i thom, "Kur të vjen qershori, më kujtohet në Prishtinë ajo shëtitorja me bli, era bli që vjen... teatri", nejse ka qenë Pallati i Rinisë, u bo qato vitet pasi kom ardhë unë. Nuk di në cilin vit u bo Pallati i Rinisë? '77 nashta.

E shkojshim atje në bibliotekë me msu e kanë pasë sallën e leximit t'mirë, nxet aty e me shoqe. I përgatitshim provimet, qaty shkojshim. Ose ka qenë edhe ni sallë e leximit përmi Mensën e Studentëve. Ku është menza e studentëve ka qenë ni sallë po u dashke me u çu herët me shku me zanë venin. M'i përgatitë provimet, me shku me mësu aty, se aty te dajhtë e kom pasë mirë, e kom pasë dhomën teme po sado kudo ni kohë ka qenë edhe... ish gjyshi u pat bo operacion e djali i dajës e e vishin mysafirë pak ma tepër, s'ish shumë atmosfera për me mësu. E shkojsha aty ose në bibliotekë. Edhe shkojshim edhe rrishim aty mirë me shoqe, u përgatitshim.

Anita Susuri: A keni shku edhe në kinema, për shembull filma kur kanë ardhë?

Hidajete Shabani Dërmaku: E në kinema, po, pak jo shumë s'më kujtohet. E në teatër kena pasë shku me e pa ni [shfaqje] "Fishekun e pajës" me dy shoqet. Tash ni shoqe e kom në Ferizaj, osht' Hyrije Bejta edhe kjo Drita Kuqi, Drita Kuqi, po. Drita Kuqi ose Shkurte. Emrin e ka pasë Shkurte të regjistrum, a Dritë i kemi thanë. Isha në, tezën e pritsha, se ajo punojke deri në ora shtatë në bibliotekë te Pallati i

Rinisë e unë dola pak në qytet edhe ka qenë Oda Ekonomike, nuk e di a është tash hala a jo? Qaty ku osht' busti i Nanës Terezë?

Anita Susuri: Po.

Hidajete Shabani Dërmaku: Po, qaty poshtë. Unë t'u kqyrë aty në vitrinë diçka, kur po vijnë ato shoqet edhe po më thojnë, "Hajde, a po vjen po shkojna në teatër?" Po thashë, "Ajo tezja më pret bashkë me u kthy te gjyshja", a din te dajhtë. "Jo, hajde, hajde". A din, u mashtrova shkova. Jom ulë po e kqyrim aktin e parë, të dytin, u çova thashë, "Jo se ata nuk e dijnë ku jom, s'ju kom kallxu". E jom kthy, u ktheva. Kur shkova, "Po pse s'ke nejtë?" Thashë, "Jo bre, me dalë me më lypë me thanë çka u bo ku hupi". E kom pasë shku kështu. Tjetër herë s'e di s'më kujtohet. Jo, s'kena dalë shumë se nuk kom pasë qef me dalë. Përpara ka qenë pak ma ndryshe. Kemi shku, kur e kemi ditë për shembull me tezën kemi shku, "Hajt po shkojmë në kinema me pa ni film", ma rrallë.

Anita Susuri: A ju kujtohet, a ka pasë ndonjë film të Shqipnisë?

Hidajete Shabani Dërmaku: Jo more, çfartë filma të Shqipnisë. S'kom pa filma të Shqipnisë asniherë. Indianë më kujtohen edhe më ka mbetë, i kom marak, s'kom pa ma kurrë.

Anita Susuri: Me kauboja filma?

Hidajete Shabani Dërmaku: Jo, jo, jo. Filma indian, romantik (qeshë) sentimental. Jo, me kauboj jo, ata s'i kom marak. I kqyrin djemtë. Përpara mu më kujtohet djemtë e hallës kur vishin prej Gilanit, ata djemtë në Përlepnice, nal të kallxoj diçka tash që e përmende. Ata shkojshin në kinema i kqyrshin, se në qytet atje i kqyrshin kta filmat me kauboj, e ku di une, e kur vishin na fmi kallabllak edhe aty në katund gratë e shkreta, na me gra (qeshë), burrat te oda. E i thojke ajo grua axhës, "Hajt o Emin kallxojau naj prallë, mashtroj pak" (qeshë). E ai u ulke aty në shkom, e kena pasë në kand edhe kallxojke filma çka i ka pa ama i merrke sikur vet me qenë pjesëmarrës. E u mbledhshin tanë fmija rreth tina u ulshin, s'bojshin zo fare fare me i qit' gratë.

Anita Susuri: E ju thatë që vitet e '80-a ka qenë koha kur veç jeni fut ne ilegale...

Hidajete Shabani Dërmaku: Po, para, s'po di, '79...

Anita Susuri: Para demonstratave?

Hidajete Shabani Dërmaku: Po, po, para demonstratave.

Anita Susuri: Qysh kanë qenë qito hapat e parë? Qysh keni njoftu njerëz? Kush ka qenë ai i pari që ju ka...

Hidajete Shabani Dërmaku: Mu më ka, ka qenë ajo shoqja Drita që më ka njoftue. Ka qenë ajo e organizume me kta, Ismajl Haradinaj e do grupin e Deçanit, Jashar Saliun e nuk e di. Nejse, unë ata s'i kam njoftë, e kom njoftë veç Dritën. Më ka afër, por na kemi bisedu përpara, se si thashë bisedonim për Adem Demaçin për veprat. Jo qarkullojke, më kujtohet atëherë e Gjergj Fishtës, "Lahuta e Malsisë", unë për veti s'e kam lexu, s'e kam lexu kurrë edhe... ka pasë edhe ma herët veprat e Enver Hoxhës, "Titistët", e ku di une.

Është ai, është me dimër, dimër, nuk e di e kemi qatë, nejse të Enver Hoxhës veprat, të Kadaresë. Të Kadaresë i kemi lexu atëherë mu më kujtohet viti '68-ën veç i botojshin në vazhdime do vepra të Elena Kadare, për shembull, "Shuaje dritën Vera" ose të Kadaresë në vazhdime, në "Zërin e Rinisë" na i merrshim "Zërat" atëherë. Ka pasë edhe kështu të lejum, po ka pasë edhe të ndalum, për shembull "Titistët" s'ke mujtë me pasë, me ta zonë të kishin çu në burg. I kemi pasë kontakt e kemi bisedu na, i shihshim, shkojshim në bibliotekë. S'kishe të drejtë m'u furnizim me literaturë, s'të jepshin edhe literaturën që kishe nevojë ti ose që dojshe me konsultu. Dukej e keqe, ni e keqe, ni padrejtësi e bisedojshim na.

Bile, Ali Lajçi s'pe di a po të kujtohet? [I drejtohet intervistuesës] Ali Lajçin në grup e kom pasë, kena qenë në të njëjtin grup. E vitin e fundit në studime e patën organizu, "Hajt po shkojna në Shqipni grupi jonë i gjuhës dhe letërsisë" te dytë. Ky Ali Lajçi kish, a din, organizoi, më duket prej tij ka ardhë ma tepër. Nuk e di a ka qenë ai kryesori a jo, por ai nuk mujt me ardhë se s'ka pasë pasaportë, Aliu. Unë e Drita e kjo shoqja nga Ferizaj e do tjerë kemi qenë në ekskurzion, ni javë kemi pasë nejtë në Shqipni.

Anita Susuri: Cili vit ka qenë?

Hidajete Shabani Dërmaku: '79 a '78 mos t'rrej, s'e di, viti i fundit qat' vjet, '79-tën.

Anita Susuri: Qysh keni shku krejt qata a mundeni me na tregu qysh u bo krejt qajo?

Hidajete Shabani Dërmaku: Kemi shku kështu, e kanë organizu kta me na çu fakulteti e ka bo kërkesën, nuk e di kush e ka bo. Të kallxova, thashë, Aliu ka qenë iniciator, por a ka qenë ai, a ka qenë edhe najkush tjetër nuk e di a din se s'jom interesu. "A po shkojmë?" "Po shkojmë". E kemi bo kërkesën, ka qenë si kusht pak notat e pak, me pasë edhe pasaportën. Unë për herë të parë qatë e kom pasë marrë pasaportën. Para se me shku na thirri i ndjeri Fehmi Agani ni takim me studenta që kishin me udhëtu, me bisedu, me na këshillu që me u përmbajtë, mos me bo...

Kemi pasë shku me autobus, me ni autobus. Nëpër Tetovë, kah Tetova atje në Qafë Thanë kemi hypë edhe pastaj na kanë çu drejt e në Tiranë. Tana prej Tiranës kemi shku në Sarandë, kemi kalu përshej Ksamilit. Atëherë kanë qenë nja dy-tri ndërtesa veç, s'ka pasë kurgjo. Qytet i ri i thojshin, qytet i punëtorëve. Kemi shku në Elbasan e kemi pasë pi ni kafe në Hotel Skampa. Në Shkodër kemi qenë, më

duket qaty kemi bujtë ni natë. Në Berat kemi shku e kemi hongër ni drekë, në hymje të Beratit s'kena hy në qytet atje, në qytet të vjetër. Në Gjirokastrë kemi bujtë ni natë, ka qenë mirë valla. Nejse, ajo tensioni, se ky burri jem nuk i don, po unë (qeshë).

Ka qenë nifare tensioni, a p'e din, ajo përcjellja, ruajtja e sene, por ka pasë rregull, ka pasë rregull. Ato farë brezaret, ullishtet, e pemtë, serrat me perime, domethonë që i kanë mbjellë masanej. Pastërti ka pasë, rregull. Nejse, fukarallëk sa të dush, fukarallëk sa të dush. Më kujtohet bile ni rast në Tiranë, ishim në mramje e kishim nifare i thojshin Ditë Preka, nuk e di, ka qenë ai i Sigurimit [të Shtetit], rrijke me neve aty. Kalunë do të njofshëm aty të tmerrum,, s'kishin qef me nejtë e njifshin, u tutshin që p'e... e shkun. Po mendoj, qishtu ka qenë. Ato kur dilshin, ato gratë me fshi qytetin me rrëmetat. A e din çka janë rrëmetat?

Anita Susuri: Jo.

Hidajete Shabani Dërmaku: E s'pe di qysh me tëkallxu, me ksi farë të drunit a din, që i kanë degat e holla, po. Me qasi e fshijshin se s'kanë pasë fshisa. Bile, kur e kom pasë lexu ni roman, jo romanin po kjo Elena Kadare i ka shkru kujtimet si biografi. Thotë, "Dilshin cisternat me la rrugtë", unë s'e di ku i ka pa ajo cisternat...

Anita Susuri: (Qeshë).

Hidajete Shabani Dërmaku: Po, vallahi. Çfarë cisterna? Ato dilshin fshijshin me ato rrëmetat. Nejse edhe s'ka pasë shumë se qitashti qaty qysh e kemi shkret. E mirë ka qenë, mirë, mirë.

Anita Susuri: Kushtet e randa i kanë pasë sigurisht?

Hidajete Shabani Dërmaku: Po, ata kushtet e randa.

Anita Susuri: Po qysh e keni paramendu ju Shqipninë që ka qenë?

Hidajete Shabani Dërmaku: Ah nalu, du me të kallxu diçka, se kaniherë, kaniherë, kam qenë e vogël po të kallxoj ato kur bojshim kallap duhonin, osht' interesant ai kallapi. Pata pa ni andërr isha e vogël, atëherë e vogël, na s'dishim Shqipninë, s'ka pasë, s'kemi pasë ide besa. Ni libër e pata gjetë, si libër leximi fill mas luftës kur e kanë bo edhe ka qenë fotografia e Enver Hoxhës aty, "Biri ma i miri i popullit shqiptar", edhe ai i bukur sa të dush. Fotografinë e tina. S'kom pasë shumë ide, a din, se s'kanë folë, s'kanë guxu njerëzit me folë as para fmive.

Po tregoj unë e pata pa ni andërr kishe shkova në Shqipni sikur ni mal, as njerëz as kurgjo. Mal, drunjë s'u doke qielli kërkund, gjethet për toke. Po kallxoj po thom qishtu qishtu, "Kom pa andërr që kom shku në Shqipni po", qishtu, "s'kom pa kurgjo". Ai mixha tha, "Ah", tha, "të nift dikush tye" (qeshë).

Edhe njëherë se kush e përmendi tha për Titon kur ka pasë ardhë në Kosovë, s'di çka po thotë. E më kujtohet baba ishte t'u marrë abdes. A p'e din çka osht' abdesi?

Anita Susuri: Po.

Hidajete Shabani Dërmaku: Ish t'u marrë abdes edhe une të kallxoj të drejtën, në shkollë na msojshin Tito, Tito, Tito edhe s'ka tjetër. Ata msustë nashta s'e kanë pasë bash prej qefit, po e kanë pasë për detyrë. Thashë, "Po vjen Tita", kisha qef me shku në Gilan me pa, s'e di a ka ardhë në Gilan ai. Edhe s'e di çka po thotë baba jem diçka p'e shan Titën. E ai axha tjetër po i thotë, "E more magar", tha, "qysh po fol kështu para fmive". Se ka pasë frikë atëherë me dalë. Ajo ka qenë koha e Rankoviqit. Me dalë fmija me folë i kanë përcjellë i kanë përgju njerëzit. E kështu.

Anita Susuri: E në Shqipni sa ju ka ra me nejtë?

Hidajete Shabani Dërmaku: Thashë nja ni javë më duket, ni javë. Ni natë në Sarandë kena bujtë, ni natë në Shkodër, ni natë në Durrës, në Tiranë ni natë a dy kena pasë shku e kena vizitu Muzeun Etnografik, Varrezat e Dëshmorëve, Shoqatën e Shkrimtarëve, tjetër s'di çka kena vizitu.

Anita Susuri: E qysh ka qenë pritja prej tyne?

Hidajete Shabani Dërmaku: Po e mirë, shumë e përzemërt. Të kallxova kanë qenë të organizume, nuk kanë qenë kështu spontane që me shku. E me këtë Dritën, kjo Drita, kjo shoqja e ka pasë ni çikë tezës a të dajës a diçka ni ilake, akraba në Durrës, e kena pasë shku na trija me vizitu ata. Po mirë, ni banesë e vogël mirë e thjeshtë e pastërt, po jo kumeditë sa. Po kumeditë kta thojshin që kur kanë pasë me pritë dikond ia kanë rregullu, s'ma merr mendja.

Anita Susuri: E kur jeni kthy, a ka pasë tani edhe, a ju kanë marrë ndoshta në pyetje kta sistemi a naj përcjellje a diçka?

Hidajete Shabani Dërmaku: Jo, jo, s'na kanë marrë në pyetje. Nuk na kanë marrë në pyetje, por tash po më kujtohet kanë bisedu me atë shogen në Ferizaj. Thotë... i paskan pasë shkru letër, a nuk e di, që kom marrë vesh që po dojnë me shku nëpër shpija m'i kontrollu kta që [kanë qenë] në Shqipëri me i kontrollu çka kanë pru libra. E i paskan pasë shkru. Unë asaj i kom thanë që, "Hiqi librat", a nuk e di (qeshë).

Anita Susuri: E ju a keni marrë libra?

Hidajete Shabani Dërmaku: Po, diçka kemi marrë me veti. Do i pata marrë i pata çu ia pata marrë adresen ni kusherinës në Stamboll. Edhe t'i marrë unë librat e mija, a din, do që ishin ma me zo edhe Dritës edhe asaj Hyrijes e t'i çoj në Stamboll. E me shku m'i marrë pastaj kur të kalojnë. Edhe kur erdh

ai axha prej Arabisë ka qenë edhe '79-ten, ka qenë '79-ten ktu prapë u pat' kthy me gru e me fmi, domethonë mas dhetë, njëmbëdhjetë vjete.

Kur u kthy i ka pasë shtatë fmi ai në veturë, grujen e sene krejt teshat. E tash ktyne ju dhimtë edhe i patëm bo pak ma ndryshe, i patëm bo do vetura do asi e ju dhimke me lonë vetëm m'u kthy ai me fmi kallabllak. "Hajde po shkojna me ni veturë", e shkova edhe une. Djali hallës edhe axha i vogël edhe unë kena shku i kena përcjellë deri në Damask të Sirisë. Ka u kthym, menzi ia mbushën mendjen atyne, "Hajde po shkojmë te aba Rifadije", ku i kisha çu librat (qeshë). Me shku m'i marrë librat.

Kur u kthym, "Hajde po shkojna", menzi që e gjetëm as pa adresë, as pa kurgjo, s'e di qysh e gjetëm. E gjetëm na, shkum qaty pari edhe s'e dishim... ni djalë i Prishtinës shqiptar, na ka njoftë ai e ka pa që jena shqiptarë. Ai na e gjetë adresën e shkum aty. Kur shkoj, a din çka, i kom marrë dy libra. "Çka ke bo?" Krejt i kish shky ajo kusherina kish pjekë pitet për ramazan (qeshë).

Anita Susuri: E sa libra i keni çu ju?

Hidajete Shabani Dërmaku: Po kumeditë tre, librat e tre vetave, s'po di sa, ma shumë se 20-30. Ajo atëherë ka qenë kjo puna e ktyne kurdëve a nuk e di, ajo Partia Komuniste e Kurdëve. Kumeditë a u kontrollojshin e u tutë ajo. Se ajo kusherinës ia kanë vra burrin në '45-ten edhe s'di cilin vit ata janë çu kanë shku në Turqi se u tutë po ia vrainë edhe djemtë. E janë shpërngulë, kanë shku në Stamboll. E tashti u tutë ajo që po ia burgosin djalin atje. Ata jo more, Ambasada e Shqipërisë atje në Turqi, ai djali ka shku aty në ambasadë e s'ju ka nxjerrë kërkush telashe për to, po kumeditë. Krejt i kish pasë çky. Çka kish lanë, veç njo po më duket, njo a dy. E bile atë librin që ka qenë i historisë i Arben Putës ia kam pasë dhanë djalit të hallës është historian në Gilan.

Anita Susuri: E qiky udhëtimi i juv deri në Damask, qysh ka qenë? Se interesant për atë kohë, s'ka udhëtu kërkush deri atje.

Hidajete Shabani Dërmaku: Kanë shku haxhitë (qeshë) pak ma larg. Po mirë, vera, vapë, nxetë. Udhëtojshim. Herë u ndrrojshim, herë në atë veturë dilshim, herë në këtë veturë. Veç ai djali i hallës ka qenë shofer i zoti. Ata kanë qenë shofera babë e babëgjysh. Babën e ka pasë shofer të autobusit që ka majtë linjën Gjilan-Beograd, bile edhe në Siri shkojshin do herë. Edhe, po mirë, dalë ngadalë udhëtojshim, nxetë. Niherë kena bujtë në Bugari pak, e në Turqi në Stamboll nuk e di a kemi bujtë a jo. Nejse, më duket anej përtej, ka Adana kena bujtë edhe ni natë në hotel, tani në Siri, në Damask. S'kena vizitu.

Anita Susuri: Qysh kanë qenë ato vendet? Qysh kanë qenë?

Hidajete Shabani Dërmaku: Mirë, osht' interesant që kur kemi shku në Damask njerëzit e bardhë sikur na edhe kta kanë pak si socialist, nuk e di si çka. Ato femrat do vajza të reja me uniforma si ushtarë.

Mirë. Po s'dishim na gjuhë as kurgjo, as anglisht as arabisht. Ata ja anglisht ose arabisht ose edhe frangjisht kanë mujtë me ditë. Ka u kthym, hajde, kena bujtë në Alepo, me ni hotel m'i thonë. Katatrofë! S'pata hongër bukë hiç. Mu s'mu hajke se unë jom pak special nuk i du gjellnat e... që s'i njofi. Ato u gëzunë, të axhës ato fmitë u gzunë kur shkum atje, se i kishin ato ushqimet që i njofin, që i hajshin. Humus është një. Kokrrat e nahutit, s'e di, a i thoni nahut?

Anita Susuri: Më doket po. Qiqrra.

Hidajete Shabani Dërmaku: Qiqrra, a qiqrra?

Anita Susuri: Shqip qashtu i thojnë.

Hidajete Shabani Dërmaku: Qiqrra po i thojnë edhe atyne të voglave si pasul që janë.

Anita Susuri: Qashtu diçka s'pe di.

Hidajete Shabani Dërmaku: Nejse, po qasi familje janë. Nahut ata e marrin ata e zijnë e tani e blujnë, e bojnë sikur sos. Kta fmitë e mi tash e hajnë atje në Gjenevë, unë nuk e du. Kurrë s'e kom hangër as atje në Arabi. Ata më thojshin, "Ha, merre provoje, provoje". U gzunë, u tranunë, ju kish mungu humusi. Edhe thojsha, "Jo", "Provoje", ai djali i hallës. E te kapi tugi, thojsha, "Qe une s'e provoj", u pata lodhë u pata bo qishtu {tregon gishin: e hollë sa një gisht} se pa hangër. S'mujsha m'i hangër kurgjo ushqimet e atëhershit.

Anita Susuri: E sa kohë ju ka vyjtë me shku deri atje?

Hidajete Shabani Dërmaku: Po, tybe s'më kujtohet, kom harru, jo.

Anita Susuri: Goxha...

Hidajete Shabani Dërmaku: Bajagi si shumë, bajagi si shumë se, a din, u dashtë me u nalë e me pushu e rrugë e gjatë. E kështu.

Anita Susuri: E ktu për, që fillum me folë në lidhje me aktivitetin e juj...

Hidajete Shabani Dërmaku: Po.

Anita Susuri: A ka qenë veç shpërndarja e librave, materialeve, a keni pasë edhe diçka tjetër?

Hidajete Shabani Dërmaku: Po na veç jemi organizu, ajo ma ka dhanë statutin, ma ka dhanë statutin e organizatës edhe...

Anita Susuri: Çka ka qenë ky statuti?

Hidajete Shabani Dërmaku: Po ka qenë çka duhet, qysh duhet, kujna duhet, kujna munësh me iu afrue, kush mundet me u bo anëtar. Rregulla qysh me ju përmbajtë, çka me bo. Me rujtë konspiracionin, mos me folë me gjithkond, mos me ju afu gjithkujt edhe kom pagu antarësinë, po s'më kujtohet sa. Mos më vet se s'e di. I kom pasë dhanë paret e ka pasë metë ajo me ma dhanë edhe organin e lëvizjes me qenë lajmëtar i lirisë, po s'ma ka dhanë asniherë, s'ma ka pru. Nuk e di çka ka ndodhë. Ia ka dhonë dikujt tjetër, s'ka pasë shumë ekzemplarë atëherë. Kontakte kena pasë. E kom pasë tana edhe me këtë kusherinin, ma ka pasë dhanë ai këtë, "Fronti i Kuq" i Ibrahim Kelmendit, organ. "Fronti i Kuq" ka qenë ni fletushkë, katër faqe s'ka pasë ma...

Anita Susuri: E çfarë përmbajtje kanë qito?

Hidajete Shabani Dërmaku: Po qito përmbajtjet që kanë kundër sistemit, kundër padrejtësive që po ju bohen popullit tonë e qysh po shfrytëzohet Kosova, qysh po burgosen njerëzit e pafajshëm. Lajmëtar kurrë s'kom lexue, s'e kom marrë asniherë. Atje kena pasë, domethonë edhe "Lirinë" edhe "Frontin e Kuq". E kom pasë këtë, "Punëtorët", "Punëtorët", a, "Punëtorja", të Abdullah Prapashticës, të Abdullahit. "Liria" e grupit OMLK-ja⁵ ka qenë [Hydajet Hyseni](#) e kta Kadri Zeka. Ata e kemi lexu. E kemi pasë atë, më duket Muhameri e ka pasë pru në '81-tën. E pastaj u zbulu grupi '81-tën.

Më kujtohet niherë jena taku me Dritën në Prishtinë, tha s'di çka, unë mendojsha që janë të organizume. Nuk janë konë bash spontane demonstratat. Ajo tha, "Ti", tha, "po mendon që janë të organizume a?" Tha, "Na nuk i kemi organizu, s'janë prej neve", domethonë, grupi jonë. Thashë, "S'po di tashti, bash pa pasë diçka vetvetiu kurgjo s'bohet". As ju s'ishit ardhë qitu pa ju thirrë unë, po. E tana kur rashë, kur erdhën, unë kom qenë t'u punu.

E kryjta fakultetin dojsha me hy në punë në Prishtinë. E ky mixha s'dojke me më lonë me ardhë në Prishtinë. Ju pata thonë... se ai kish mundësi me të njofshëm e sene, se gjithmonë me të njofshëm ka shku kjo farë pune të punësimit e sene. Nuk dojke me intervenu, a din, përpara. Po kur i thashë, kur e pa që po kqyri me hy në Prishtinë në punë e ma gjetë në [shkollën] "Selami Hallaqi" vendin e punës. Kom punu veç dy muj ditë...

Anita Susuri: Në Gjilan si mësimdhënëse?

Hidajete Shabani Dërmaku: Po. Dy muj ditë, domethonë ia kom nisë me 8 mars. Me 11 mars më doket janë bo demonstratat e para a?

Anita Susuri: Po.

⁵ Akronim i Organizatës Marksist-Leniniste të Kosovës.

Hidajete Shabani Dërmaku: Edhe me 12 maj më kanë arrestu. Te shkolla kanë ardhë më kanë marrë. Kur më morën, kur më morën e dita që ma s'kom vend në shkollë. E i kishim në shpi edhe e disha osht', "Liria", e kishim libra e kishim gazeta tjera aty edhe u deshtë me pranë që jam anëtare e organizatës, me dorëzu statutin që e kisha marrë. Po nuk më dënunë, nuk më dënunë me burg, a din. S'më kanë qit në gjygj fare, po më përjashtunë prej punës.

Bile, ky axha ka haru, a din se, plaku i ka bo 90 vjet. Po thotë, "Ti pse dhe dorëheqje?" Thashë, "O axha jem", thashë, "kom dhanë dorëheqje se s'e kom pasë qare". Unë s'kom dhanë dorëheqje, po ata më kanë detyru me dhonë dorëheqje se s'kom pasë vend, ata mirë që s'më kanë burgosë. "Qysh?" "Po", thashë, "unë kom qenë e organizume". Ata për ma pak i kanë dënu njerëzit, për ni parullë që e ka shkru dikush në muri, ni fmi.

U deshtë me... e disha që janë ato tjerat, thashë kur shkojnë ato tjerat... fati ata kanë kontrollu, kanë bastisë shpinë po s'kanë ra në to. Bile i kishin pasë marrë do libra që i kom ble ktu në Prishtinë. Ka qenë, "Liri a vdekje", e Miko Kazonçit ai është autor grek. Ndoshta qysh i përshkrun ai aty në roman osht' sikur, do adete si shqiptare, a din. Po nejse, grek. Bile thashë, "Çka e keni marrë kta?" A din. "E kemi ditë se çka osht' po veç e kemi marrë", ata në UDB-e më thojshin.

Anita Susuri: A ka pasë kështu dhunë fizike ndaj juve?

Hidajete Shabani Dërmaku: Jo, jo. Nuk mundem me thanë që më kanë, se s'më ka prekë kërkush. Dhunë fizike jo, po psikologjike sa të dush. Psikologjike dhunë sa të dush, a fizike kërkush s'më ka prekë me dorë. Nuk p'e di, tashti, se ka pasë tjerë që i kanë rrah, i kanë malltretu. E unë '81-tën domethonë kur më kanë marrë, më kanë majtë ma shumë se 24 orë, s'e di s'më kujtohet bash mirë, kom haru. E morën edhe babën atëherë, më kujtohet edhe vllaun e madh. E pastaj vitin tjetër pasi ka ra Muhameri në burg, atë ditë, kur ka ikë prej burgut Muhameri kanë ardhë më kanë marrë të nesërmen. Ai ka ikë natën mes të shtunës dhe të dielën, mu kanë ardhë të dielën, s'e di ndoshta kah dymbëdhjetë me thanë.

Pjesa e Katërt

Anita Susuri: Paraprakisht çka ju kujtohet për demonstratat e '81-tës?

Hidajete Shabani Dërmaku: Paj, demonstratat e '81-tës ka qenë, vlojke, veç përgatitshin njerëzit ishin të pakënaqur. Ata të pakënaqur kanë qenë gjithmonë, kanë qenë edhe ma herët se ka pasë dhunë edhe ma shumë. Por tashti mu më kujtohet, se unë s'kam qenë atëherë studente në '81-tën, kam qenë në shpi. I kam pasë kry studimet edhe... po i kom pasë këtu, motra e asaj shoqes të Ferizajit ka qenë në

konvikte banojshin. Kanë qenë disa vjaza të Ferizajit, ato nuk e di a kanë qenë të organizume veç shumë kanë folë (qeshë).

E ky Emrush, Emrush Xhemajli, s'di a p'e dini, Emrush kanë pasë ra në burg qatëherë e ai Xhabir Morina e një Topalli, ia kom harru emrin, Enver Topalli. Kta patën ra, u patën burgosë. E flitshin ato, ato si me qenë të organizume në qat' grup, ma çojshin mallin... s'e di ma si kom pa. Studentat, po thom, ishin të pakënaqur, vlojke nifare atmosfere e ish e tendosur. E mu qysh më kujtohet edhe për këto demonstratat, tash po thojnë, "Jo unë i kom nisë, jo unë e kom mërthy pjetën e kom përmbysë", mu më doket që qato vajzat e Ferizajit e kanë bo. Se kur shkojsha në dhomë, kom pasë shku qaty a ju kom çu atyne, "Lirinë", a e kom marrë te ato, kom harru. Nuk e di, s'di çka të thom veç të rrej. Ato flitshin që njëna prej tyne e ka përplasë pjetën.

Anita Susuri: E kështu atmosfera në qytet qysh ka qenë?

Hidajete Shabani Dërmaku: Qysh po mendon në qytet?

Anita Susuri: A ka pasë polici shumë?

Hidajete Shabani Dërmaku: Jo, jo. Atëherë ka qenë pak ma ndryshe në atmosferë po mendoj në ato vitet e '75-tës...

Anita Susuri: Jo, '81-ten.

Hidajete Shabani Dërmaku: A kuku mos ma përmend '81-ten se unë kesh në shkollë, atë ditë e kisha të lirë. Domethonë, me 11 mars janë bo demonstratat, në mramje unë me 12 [mars] kom ardhë në Prishtinë edhe shkova te dajhtë. Kur shkova Muhameri ish kanë aty ju kishin pasë ajë sytë kështu prej gazit që ju kanë qitë. Ai ka qenë në demonstrata. Shkova unë, shkova te ato në konvikt a nuk e di. Katastrofë ka qenë, sa policia, sa nami, sa ushtria. S'pe di tashti me 11 apert... na nalën në hymje të Prishtinës ku është qaty Albi Malli tash. Na nalën, dulën na kontrollun krejtve policia edhe u kthym prapë. Shkova unë te ky kusherini te Qerimi ka banu në Taukbashçe në atë kohë. Ata e kanë pasë marrë atëherë në izolim.

Kah konviktet, o zot policë çdo dhetë hapa, çdo dhetë metra te nalke policia me të identifiku. Konviktet i kishin pasë nxjerrë studentat krejt prej konvikteve i kishin pru policët a s'di çka kanë bo aeroplanat. Ka qenë qytet, qytet i okupum. Qytet, nuk e di, ato veç nëpër filma a nëpër s'po di qysh me ta përshkru, ka qenë qytet i vdekun, qytet i vdekun. Jo qytet i vdekun, po qytet i terrorizum, qytet i terrorizum. Në njëren anë aeroplanat, në njëren anë policia, në tjetrën anë ushtria. Ushartë a, ushtarë të kontrollojshin jo policë, ushtarë.

Derisa shkova atje në Taukbashçe kumeditë sa herë të kanë nalë policia, sa herë të kanë nalë policia katastrofë, ma shkurtë. Edhe nëpër Gilan edhe në katund, në hymje të katundit tonë i patën pru ushtrinë a, ushtrinë aty rrishin rregullisht. Katundi jonë e patën bo, e patën bo ni ndërtesë të vogël për me bo postë a nuk e di çka. Kurrë s'kena pasë telefon, kurrë telefon s'kem pasë. E bonën çka, e bonën policia nuk e di se çka bonën, kom harru tash.

Anita Susuri: E në familje te ju, për shembull ju keni qenë e organizume, Muhameri ka qenë i organizum, a e kanë ditë të shpisë tjerë që jeni ju pjesë?

Hidajete Shabani Dërmaku: Jo, jo, s'e ka ditë kërkush.

Anita Susuri: E ti a e ke ditë për Muhamerin ose ai për ty?

Hidajete Shabani Dërmaku: Unë e kom ditë pak m'ka kallxu kur janë bo demonstratat e 2 prillit. Ai e ka taku Hidajetin, nashta ju ka kallxu?

Anita Susuri: Po.

Hidajete Shabani Dërmaku: E m'ka kallxu që e ka pa Hidajetin, ama s'më ka kallxu që është i organizum. Ia kish pasë lidhjen me Mejtullah Tahirin të Malishevës, vllau i atij që u vra në luftë, u vra në Burg të Dubravës më duket. Jo, jo, s'kena folë na, s'i kena kallxu kërkujt. As unë s'i kom kallxu Muhamerit, Muhameri s'e ka ditë që jom e organizume me Dritën.

Anita Susuri: E ku keni qenë ju kur është burgosë Muhameri edhe qysh e keni marrë lajmin?

Hidajete Shabani Dërmaku: Kom qenë në Gilan unë, kom punu te axha punojsha në shitore. Qysh e kemi marrë vesh, se e kanë marrë djalin e hallës, Ahmetin, s'pe di a ju ka kallxu Muhameri. Po djali i hallës u konë i organizum ai me Muhamerin edhe kanë shku e kanë marrë në mëngjes herët ata në banesë edhe unë te halla kom shku gati për çdo ditë se në katund s'mujsha me shku. Punojsha në shitore e në drekë nuk m'jshe m'u kthy në katund, menzi që vishe niherë se s'kishe as autobusa.

Dilshe me marrë autobusin e tetve nuk vijke, hajt të dhetve nuk vijke, të dymdhetve bon vaki as i dymdhetve nuk vijke, u nisshe në kamë. Tash për drekë shkojsha te halla o te axha shkojsha. Kom pasë tre axhallarë aty. E po më kallxon, erdhën çikat e hallës, a kom harru valla, më kallxun që e kanë marrë Muhamerin. E kallxoj halla tha, "Ku p'e çoni?" Ka thanë, "P'e çojna te daja i vet, te djali dajës të vet", te Muhameri. E po. Kom pasë shku besa unë atje në Prishtinë edhe në Sekretariat... jo s'e kom ditë, e kom ditë.

E ka pasë nifarë shoku, ai vijke, hijke, dilke. Ai jo i organizum, po krejt i ka ditë senet. Edhe mu gjithë më shkon mendja që ai e ka bo, ai i ka qitë [lajmru në Sekretariat]. Se ai ka ardhë, ka hy, ka dalë në shpi

tonë e te ajo halla si në shpi të vet e te krejt. Edhe në atë banesën ku ka banu Muhameri me atë Bajrush Xhemajlin, ai ka qenë [edhe aty]. Tana... unë shkova besa në Prishtinë, ma së pari shkova te ata, te ai djali. Unë kujtova që e kanë burgosë edhe ata, a din, kur tha, “Jo, jom kanë në fakultet më kanë lypë”, a s’di çka thojke. S’e kishin lypë hiç. Ai ka qenë i fejum edhe m’duket janë martu me motrën e tij, Bejtullah Tahirit. Unë mendoj Muhameri ka hi në kontakt me të përmes këtij Bejtës e motrës së Bejtës, ka mendu që... e tana... e masanena ai i kish pasë thanë shkoi baba në vizitë ish ‘83-shi, fillimi i ‘83-shes, nuk e di çfarë date ka qenë. Ishin në vizitë po thotë, “Nal, nal!” Unë isha hi me i la teshat, nana ish e smutë ratë...

Anita Susuri: Po paraprakisht a keni shku te Muhameri me e pa?

Hidajete Shabani Dërmaku: Po mori, qysh jo.

Anita Susuri: Qysh ka qenë për shembull hera e parë kur keni shku? Kur e keni kuptu që u dënu ose...

Hidajete Shabani Dërmaku: S’u dënu Muhameri.

Anita Susuri: Nejse, s’u dënu...

Hidajete Shabani Dërmaku: Jo, jo, s’u dënu Muhameri, s’ka dalë në gjykim hiç Muhameri. Në gjykim kanë dalë shoktë e vet masi ka ikë Muhameri në ‘84-tën. Po tybe ti, ku di une, jo me shku kemi shku me rregull a din se u deshtë dy-tre vetë, s’ke pasë të drejtë më duket ma shumë se dy vetë më duket në vizitë. Kom shku e kom pa, po çka ke pasë me pa aty përmes atyne grilave? A keni qenë atje?

Anita Susuri: Po, po thojnë që i kanë ndrru qato grila kanë qenë ma keq?

Hidajete Shabani Dërmaku: Jo, jo, s’kanë qenë ma keq. Boll të kqi ishin hala qashtu, boll keq ishin s’po di qysh munden me kanë ma keq. Jo, po s’kemi pa kurgjo. Ka dalë ai aty mirë, s’u dhonë. U deshke m’u majtë, me majtë vetën, “Hajt se burgu për burra osht” (qeshë). S’osht’ as për qen po edhe qashtu. Edhe kemi shkru letra. Thojke gjithë, “Mos më çoni, çka po shpenzoheni”, ju doke, a din, ju doke e panevojshme me...

Anita Susuri: A çojshit, për shembull, paketa diçka, ushqim?

Hidajete Shabani Dërmaku: Po, i çojshim paketa, po me më pre nuk e di çka i kemi çu. Mjaltë e di i kemi çu. Thojke, “Pse po më bini mjaltë?” I thojsha, “O vllau jem, ha mjaltë se bleta shkon në lule e në lule, dru në dru, e pak në natyrë. Përmes mjaltës të jep, i ki krejta në to”. I kemi çu, tybe s’po di, pula (qeshë). Pula, ku di une, bakllavë. Niherë ka qenë ni shok i Muhamerit, Ramadan Veliu. I kish pasë lypë nanës të vet bakllavë. Ata pak e kanë pasë më duket gjendjen pak si ma të vështirë e sene e une nanës, “Hajde moj nanë me tëhollu bakllavë”. Unë për veti s’di as sot me tëhollu bakllavë. Me gjetë tlynë me

bo ma të mirë a din, e qishtu. Me iu çu atyne të burgosurve. Me iu çu edhe Bajrushit, e Ramadanit, e Muhamerit m'duket edhe Muhamerit, po, po edhe Ahmeti, ai djali hallës ka qenë. Po s'e di sa herë ka qenë vizita, a ni herë në mujtë a dy herë në mujtë?

Anita Susuri: Dy herë në mujtë më duket.

Hidajete Shabani Dërmaku: Dy herë në mujtë. Më duket që dy herë në mujtë. Po, po, kemi shku në vizitë. U ndajshim, ni herë, a din, rregullisht s'ka pasë shumë veç interesant ka qenë atëherë ai djali, ai kusherini ka pasë shpreh dëshirën me ardhë me vizitu qatëherë kur ia kena çu sharrën edhe s'pe di a ka qenë najkush tjetër. Jo nuk dojshin me ardhë njerëzit, se u tutshin atëherë.

Anita Susuri: E qysh u konë gjendja e prindërve të tij për shembull?

Hidajete Shabani Dërmaku: Qysh po mendon?

Anita Susuri: A janë konë, po mendoj, të shqetësuar, sigurisht janë konë po a ju kanë kallxu, a?

Hidajete Shabani Dërmaku: Jo, janë konë të shqetësuar sigurisht, kanë qenë të shqetësuar po baba ka qenë krenar me siguri e nana edhe nana. Veç... po, jom mërzitë sot. Më kujtohet edhe ni çikë të hallës e kom pasë bojke xhempera atëherë, "Me ia maru Muhamerit ni xhemper se e ka ftoftë aty". Vështirë ka qenë se, po mendoj, njerëzit edhe na akuzojshin atëherë, "Na e prishët rehatinë. Mirë kem, sa mirë kem na prishët rehatinë". U deshke luftë me bo, me luftu me njerëzit e tu ju thonë që s'e keni mirë ju. Luftë në dy antë. Veç me thanë të drejtën nuk e di po ne aty në katund e kemi gëzu ni respekt, po mendoj. Se kush nuk ka kalu pa të përshëndetë me të thonë, "Mirëdita", kurrë. Kom udhëtu me autobus Përlepnice-Gilan kurrë në kamë s'kom nejtë, gjithmonë ma kanë lëshu vendin, po. Mendoj ka qenë pak si satisfaksion, a din si...

Anita Susuri: Po, po edhe ni lloj mbështetje ndoshta.

Hidajete Shabani Dërmaku: Mbështetje po. Njerëzit flitshin, "Na e prishët rehatinë", a ta prishëm rehatinë? E tash prapë po dalin po flasin po thojnë...

Anita Susuri: E qysh po ju kujtohet qikjo krejt rasti kur ju ka ardhë në të brendshme ajo letra?

Hidajete Shabani Dërmaku: Po, mu më kujtohet kurrë s'e harroj (qeshë). Po më doket p'e shoh vetën se e kemi pasë si i thojshin mutfak përpara si shpi atje. Ajo ka pasë nja dy dritare po murin e ka pasë meniherë terrushme e aty veç me dritë. Po dimrit i lejshim teshat qaty pak ma nxet, mos me dalë në oborr. Edhe ai, unë isha, dola thashë t'i laj teshat që kishin ardhë të Muhamerit edhe tonat natyrisht. Nana e smutë se ajo kur ka qenë në kamë ajo s'më ka lanë me la teshat, ju ka dokë që s'pi laj mirë (qeshë).

Edhe jom shku unë aty m'i ulë teshat m'i shti m'i la kur po vjen baba, "Nal, nal, nal!" "Çka?" "Jo, se Muhameri u prekke qitu diçka" {prek te beli}. Mu më shkoi mendja mos po mendon që janë të përgjakta, a din, diçka mos po... unë hala s'i kisha kqyrë a po din. Edhe i kom marrë i kom fut në ujë, i kom shti në ujë qashtu, "Jo", thashë, "s'kanë kurgjo... qe s'kanë kurgjo". Ai i kqyri edhe u kthy. Kur u kthy, ai tashti mu masi m'tha ashtu më shkoi menja me siguri e kom marrë me ngreh llastëkin. Kur e kom ngreh llastëkin e kom pa që s'po ecë, se kur është veç llastëk shkon ma lehtë. Nejse edhe kur jenë të lagta pak ma zor shkon.

E kom gjetë letrën. Ka lypë sharrë. A ka shkru edhe diçka tjetër nuk më kujtohet. Po tani e kemi zhdukë letrën, nuk kemi guxu me rujtë. Deri në vizitën tjetër ndoshta, në vizitën tjetër ia kemi çu, a s'më kujtohet. Fola unë me Samiun, vllaun, edhe me atë djaln e kemi edhe djalë tezës edhe të axhës edhe ai ka qenë në burg nja dy muj ditë '82-tën e kanë marrë kur u bon përvjetori i demonstratave e kanë pasë burgosë. Edhe thashë, "Me ble sharrën". Me shku me ble sharrë, sikur me shku, a din, isha e përcjellun nuk isha bash rahat. Ata kanë shku e kanë ble, nuk e di se ku e kanë ble.

E te Pallati i Rinisë aty nalt që osht', qaty e kanë vnu në majonez e kanë shti atë tehun edhe e kemi bo bashkë me sene tjera. Me 26 mars ajo ka qenë si, nuk e di, se ka qenë nifarë date interesant, mos ka qenë fillimi i marsit, si 11 mars a nuk e di se kish pak ma shumë lëvizje, a din...

Anita Susuri: Për përvjetorin e demonstratave.

Hidajete Shabani Dërmaku: Për përvjetorin e demonstratave kish si përcjellje pak ma shumë. Hyni ky kusherini edhe ky vllau paska hi, se unë s'e kom ditë ma s'e kom majtë mend. E shkova... po, edhe unë kom qenë aty që në rast se helbete ndodhë diçka. Ma mirë, ma mirë une se m'u marrë kta djemtë. Po ata edhe s'shkojshin ma larg. Me 26 mars, domethonë, aty kah i 11-ti ka qenë me 26 mars më kanë marrë, më kanë arrestu UDB-a.

Isha në dyqan t'u punu, s'e di më doket ka qenë e shtunë, po e shtunë. Erdhën më morën edhe shkova. Po s'e dita se çka u bo. Mendojsha, thojsha, ia paskan zanë sharrën Muhamerit e kanë ardhë me më arrestu. Të njejtën ditë e kishin arrestu edhe motrën e Hydajetit të voglën edhe ni kusherinë te Hevzija e Shemsiut, është ky Shemsi Sylja që është gruja e tij, Mexhidja. Unë s'e disha, na morën na çunë qaty edhe ma kërkush s'na foli, as s'na veti, as kurgjo.

Veç më kujtohet ka pasë ardhë ni polic edhe po thotë, "Ktu", motra e Hydajetit ka thanë, "po më dhem krytë, a po ma gjeni ni hap", a din. E ka shfrytëzu rastin edhe ka dalë në koridor edhe unë në koridor e u takum e pamë që edhe ato janë edhe une. Edhe po na thotë ai, "Hajt mos e keni gajle", se frik ka vdekë ai polici tha, "kurgjo s'ka, kurgjo s'ka". A kish pas pasë, se kishin pasë shpërnda afishe me rastin e 26 marsit aty në katund tonë. E tash kta ia nisën me më vetë kush ka qenë të pramët aty te na e çka keni bo anej knej. Më mbajtën, dy ditë më kanë mbajtë a.

Merre me mend, që po thu ti, të dytën natë a e inskenun, a e rrehshin dikond, nuk e di, veç bërtima, të rrahme, a din, me më frikësu mue... bërtitshin, s'e disha çka u bo, a din. Tani më shkojke mendja që bon vaki e kanë lëshu kështu naj magnetofon a ku me ditë a e kanë rreh najkond. Tana më lëshunë. S'e di a e patën marrë edhe dikënd tjetër prej shpisë. E pastaj për Muhamerin po...

Anita Susuri: E aty veç ju kanë marrë me ju izolu për përvjetorin që ka qenë i demonstratave apo?

Hidajete Shabani Dërmaku: Jo, jo, jo. Janë shpërnda afishe edhe më thojshin, "Ti tash ktu ki me qenë e rregullt, si të ndodhë diçka ty kena me të marrë. Sa herë të ndodhë, sa herë të bohen përvjetoret". Kallxojshin për njërin, ata flitshin ata UDB-ashët mes veti, tha për njërin, "Khu, nanën bre, tash e bojke çantën gati hala pa shku me marrë", se e ka ditë që e marrin kur ka ardhë Tito në Kosovë që u bojke naj përvjetor a diçka. Tha, "E bojke", tha "çantën gati hiç pa..." (qeshë)

Anita Susuri: E dike që vijnë.

Hidajete Shabani Dërmaku: "Që vijnë e marrin edhe ty", tha, "sa herë të ndodhë diçka kena me ardhë me të marrë". Eh çka me bo...

Anita Susuri: E qysh ka qenë për shembull reagimi i familjes të juj, i nanës, i babës në ksi raste?

Hidajete Shabani Dërmaku: Po din me thanë, "Hajt bija jem mos e ki gajle", po asniherë s'më kanë marrë në shpi. Herën e parë kur më kanë marrë kam qenë në shkollë. E kryjta orën e mësimi ishin në fund të shkollëve ai UDB-ashi, a Sekretar, a s'di çka ka qenë i shkollës tha, "Po dojnë me bisedu me ty diçka". Tani më kanë çu prej Sekretariatit atje në katund me shku me marrë, "Jo, jo", ata thojshin, "s'kem lidhje". Po baba s'ka qenë shumë mirë atëherë, ai ka qenë pak i smutë e nana edhe ajo nana ka qenë e dobët prej shnetës, e dobët prej shnetës edhe më dhimet se i kemi sjellë telashe. I kemi sjellë telashe.

Anita Susuri: E qat' moment që e kuptut edhe që e gjetët qat' letër kujt i keni tregu?

Hidajete Shabani Dërmaku: Kërkujt. Veç atyne vllaut edhe atij djalit të axhës, kërkujt s'i kom kallxu. Baba s'e ka ditë kurrë. Jo, jo, s'e ka ditë. Kërkujt s'i kom kallxu as babës, as nanës. Jo moj qysh m'i kallxu nanës. Me ta thanë të drejtën pak jom hamend. Me ia çu sharrën, qysh me ia çu, mos me ia çu, qysh mos me ia çu. Prapë kemi vendosë me ia çu.

Anita Susuri: A keni mendu për shembull çfarë pasoja kish mujtë me pasë nëse ia kishin gjetë ose...

Hidajete Shabani Dërmaku: Po de.

Anita Susuri: Për qët' arsye...

Hidajete Shabani Dërmaku: Me ia gjetë çfarë pasoja po edhe me ikë e me dalë. Kur ka ikë Muhameri, ajo motra e vogël kish pasë... (qan) "Shkojshim e shihshim".

Anita Susuri: A doni me pushu pak?

Hidajete Shabani Dërmaku: Jo, se prapë kur të flas ia nisi. "Shkojshim e shihshim në vizitë, pse ka ikë?" Ka qenë, qysh me dalë... E kur më morën mua, thojshin, "Ti e din çfarë krye ka ai, kena me vra". Imagjinojsha që nime po e vrasin.

Anita Susuri: E te kjo pjesa kur u ikë ai prej burgut, qysh ka ardhë lajmi edhe qysh u zhvillu pastaj ngjarja në familje te ju, te ti?

Hidajete Shabani Dërmaku: Lajmi ka ardhë se ata kur kanë marrë vesh që ka ikë Muhameri, ata Prishtina sigurisht e kanë lajmëru Gjilanin. E kanë ardhë dy vetë prej Sekretariatit të Punëve të Brendshme në dyqan të babës aty. Se ai ka qenë, e pamja e atij axhës që ka pasë vdekë në Arabi. Dy shpija vlojshin prej njerëzve që vishin për ngushëllime. Na jemi familje shumë e madhe, s'e di a të kom kallxu, 50 jemi kushëri edhe kusherina të hallave edhe të axhallarëve, 50. Nejse tash jemi rrallu pak se na kanë vdekë do, veç 50...

Anita Susuri: Kusheri të parë, domethonë 50.

Hidajete Shabani Dërmaku: Të parë kusheri po, veç të partë jemi. Tana ata tjetër s'pi numëroj, se s'i di as s'i njoh, as s'ju di emrat krejtve. Tani secili, po mendoj, secili miqtë e vet e janë bo shumë. Tash vishin edhe ata miqtë e nipave me pa e kanë ardhë ata, ky mixha që është në Gilan edhe baba po më duket, s'më kujtohet për babën s'e di. Kanë ardhë ata aty në dyqan... jo ata s'më kanë tregu pse po më marrin... po ishim t'u përgatitë drekën për mysafirë se vishin përpara pak u kanë ma nuk është sikur tash. T'u përgatitë na kallabllak aty, s'di kush ka ardhë më ka thirrë më ka thanë, "Hajde".

Kur shkoj, më duket ka qenë Haqif Guga edhe s'di kush ka qenë edhe ni tjetër edhe m'thojnë... vajza e axhës erdh edhe në vesh po më tregon tha, "Hiç mos e ki gajle", tha, "Muhameri ka ikë prej burgut për qita kanë ardhë me të marrë". O vet me veti çka më kallxove, a din. Thojsha ma mirë mos ta kisha ditë se pse. Më kanë marrë më kanë çu në Gilan, nuk e di a m'kanë marrë në pyetje, a m'kanë vetë najsen, s'di! Edhe më kanë çu drejt në Prishtinë.

Në Prishtinë ka qenë e diel atë ditë dhe stadioni i futbollit po më doket qaty ku osht' tash ka qenë edhe atëherë lujke Prishtina me dikond. S'di me kond kanë lujtë. E krejt kta edhe UDB-ashët t'u e kqyrë futbollin. Më kujtohet nja dy vetë atje... kështu s'më kallxoishin knej, "Ti e din qysh është ai, çfarë krye ka" tha, "i thojmë nalu, ai s'nalet. Kena me vra", e s'di çka. Unë u bojsha që s'po di kurgjo. S'po di as

për çka më kanë marrë, as çka po më thojnë as hiç. Nejse, atë natë ata shkun me kqyrë futboll a kumeditë dreqi ku shkun se e dille e m'kanë lonë poshtë te hymja, qaty dikund osht'. Me ni si atje në Zvicërr i thojnë [flet frengjisht], si ni dy me dy a...

Anita Susuri: Naj kabinë.

Hidajete Shabani Dërmaku: Si kabinë, po. E miza e asi edhe ma kishin lanë ni nxemje, ni nxemse qaty. A unë me mangë të shkurta qysh jom konë në shpi, veç jom dalë qashtu s'kom marrë kurgjo. As me thanë merr diçka se s'e ki për pak, a din. Atë natë e të nesrit kta në Prishtinë s'e di a më kanë marrë n'pytje prapë dikush a jo. Më kanë hypë në veturë e, "Hajde me shku te shpija e dajve me pa ku osht' shpija e dajve", në Ulpianë është qaty.

Kapërcym përskejt edhe e panë aty që ajo ndërtesa në tana antë që s'ka hy aty. Edhe drejt në Mitrovicë. Aty vishin më merrshin në pytje herë mas here. E merrke ni libër ai, "A pe sheh qita", a e din knej kah është lidhja e librit, "a p'e sheh qita?" "Po", thojsha, "p'e shoh", ata mendojshin mos ia kom shti qat', mos ia kom shti aty sharrën. A njoni në Prishtinë m'pat thanë, "Na e dijmë nëpër turrshija", anej e te knej. Vet me veti ia keni qëllu. E qishtu. Më vetshin kond e ka shokë, e ku i ka, e qysh i ka. Thojsha, "Nuk ia di shoktë". Nime nuk ia kom ditë, ku e di unë sa shoktë i ka pasë Muhameri.

E ka pasë ata Nuhi Berishën edhe atë Ahmetin e qët' farë Halilin. E veç Halilin ia përmendsha, thojsha, "Halilin". E kështu më lshunë tana. Më lshunë po më kanë përcjellë, ata më lshunë me qëllim. Kanë deshtë me ditë që mos po merr kontakt Muhameri me mu në dyqan a diçka. Prej Prishtinë s'e di kush kish pasë thanë i kish pasë pa tha kerrin. Prej Prishtinës kanë ardhë apostafat me më përcjellë. E atë natë kur ka ardhë Muhameri, unë s'e kom ditë që po vjen, veç kur ka hy.

Agja u konë shumë, baba jem u konë shumë i shqetësuar. Kishim, a din, kish tjerë edhe aty që s'u deshën me kanë. Kallabllak na atë ditë të pamës e rishin aty. Veç ka thanë, "Kërkush nuk guxon me kallxu kurgjo hiç kërkujt", edhe ka ardhë me ni letërnjoftim të Sabit Mushiqës, ai ka vdekë tash. E ka lonë letërnjoftimin e Sabitit aty e ka marrë të vllaut, Samiut letërnjoftimit edhe ka shku meniherë. Jemi përshëndet qaty edhe shkoi...

Anita Susuri: A ju ka tregu, për shembull, planin çka e ka a kah po don me shku?

Hidajete Shabani Dërmaku: Jo, jo, jo. Çfartë! Qysh me tregu planin, kujt me i tregu? Nanës e babës thojnë edhe krejt dynjajës. S'bon m'i kallxu planet. Po edhe nejse baba, po get i kish pasë mbledhë do të holla ia ka dhanë. Jo, jo, s'kemi vetë kurgjo. Na pastaj vishin ata më përcjellshin, më kontrollojshin, unë jom ruajt shumë. Kurrë në dyqan s'kena folë me kërkond. Më kujtohet masi kanë dalë kishin dalë në Itali ka ardhë ni kusheri, vllau i këtij Qerimit edhe s'e di unë a e disha a jo. Ma ka shkru në gazetë, u ulë aty e kena pasë ni termo, a din ato termot qysh janë në shitore?

Anita Susuri: Po.

Hidajete Shabani Dërmaku: E në qosh të gazetës “Roma”, me më kallxu që në Itali janë. Edhe kurgjo. Pastaj, çka deshta me thanë, po, kemi marrë vesh. Ai Zija Shemsiu na ka kontaktu babën edhe e kanë thirrë natën, kanë dalë në ara, s’kanë folë në shpi po natën në ara. Aga s’e ka ditë kush osht’ ai person, veç e ka ditë dikush prej jashtit e i ka kallxu që Muhameri ka dalë jashtë. E na, aga kur ka folë me mue ka folë veç me mue, nana s’ka qenë prezente. Kur ka folë me nanën ka folë veç me nanën edhe unë njisoj, s’kena folë. Në dhomë të veçantë edhe veç kah dy vetë, tre s’kena bisedu kurrë. Se qysh ishim veç u çelke dera e oborrit e kumeditë qysh thojnë, “Mali ka veshë e fusha ka sy”. Jemi rujtë shumë.

Osht’ ka më vjen keq, e kena pasë ni axhë ai s’ka pasë fmi, nuk e di sa vjet. E ka pasë gjashtë fmi, po na vllëzërit e mi i kanë bajtë kah kanë shku mas veti edhe Naserin edhe Muhamerin. Kah ka shku i ka bajtë mas veti, a din, i ka dashtë shumë. E ditën e bajramit erdh edhe ia nisi me qajtë tha, “Na po hajmë e po pijmë e ai kumeditë ku osht’” E më vjen shumë keq pse s’i kemi kallxu atij.

Pjesa e Pestë

Anita Susuri: E mas sa kohe keni folë direkt me Muhamerin ju?

Hidajete Shabani Dërmaku: S’po di, po, shumë gjatë nashta. Shumë gjatë, nuk e di.

Anita Susuri: Ndoshta kur keni dalë ju atje a?

Hidajete Shabani Dërmaku: Jo, jo, ma herët, ma herët kena folë. Na ka pasë çu ni numër të telefonit. E kom thirrë edhe unë prej postës e kom thirrë kaniherë. E kom thirrë prej postës. Por, jo, jo, sa kam qenë ktu kemi folë. Tana ka çu edhe kontakte kështu njerëz, a din. Në telefon edhe me folë, “Qysh je, a je mirë?” Kurgjo ma tepër, çka ki me folë? Po. E bile me këtë axhën po flasim, po thojnë, po thotë, “Seftë ka folë te na”, a din, për herë të parë. Ka folë me ta, ka kallxu që osht’ mirë. Kanë ardhë ata na kanë kallxu.

Na s’kemi shku me folë e me asi se atëherë ka qenë situata... ata në ‘82-tën e vrajtën Kadri Zekën e Jusuf Gërvallën. Ky ‘83-tën iku, ‘84-tën domethonë, tashti ti me folë në telefon. Ti, ata nuk mujshin ndoshta krejtve rend me ju hy, po tash qysh ka thanë, “Ti duhet me u rujtë pak, unë të rujë shumë”, që ka thanë zoti, ruju pak na të rujna shumë. S’mujsh me rreziku edhe ata kur thirrshin te axha që thirrshin në telefon edhe ata kanë mujtë m’i marrë në pyetje, a m’i... nuk ka qenë shumë e udhës edhe e lejushme me dalë edhe me folë në telefon. Ata boll që kanë pranë me të kallxu që mirë osht’, lajmin e mirë me dhanë.

Anita Susuri: E a keni pasë ma, a ju ka kontaktu ma policia mas asaj që kanë ardhë në shpi qat’ ditë edhe që ju ka marrë juve? Ma a keni pasë ndonjë...

Hidajete Shabani Dërmaku: Jo, ma s’kanë ardhë asniherë. Me më përcjellë më kanë përcjellë kah kom shku. Bile më kallxoi ky farë ‘83-ten që m’kanë marrë, ma nuk më kanë marrë mu. Në ‘84-ten s’kam qenë asniherë në polici, as ‘85-tën, ‘86-ën ma kom dalë. Nuk më kanë marrë asniherë, po kam qenë e përcjellun, e di që kam qenë e përcjellun. I kom vrejtë, i kom pa. Edhe tash më tregoi ai Shemsi Sylja sivjet, ka qenë përvjetori i vrasjes së Zija Shemsiut, shkum te varrezat, a din, për përkujtim. E po më tregon tha, “Vishin në shitore aty kishe po blejna këpuca, vishin kta”, tha, “kur më kanë marrë në ‘86-ën”, e kanë burgosë ata [Sekretariati] e kanë marrë ni grup e tha “më kanë thanë, ma kanë qitë fotografinë t’u dalë prej dyqanit tond. ‘Çka ke lypë ktu?’”

Edhe kush, po, mbasi kom dalë jashtë ma kanë marrë motrën a nuk di kënd edhe e kanë qit’ fotografinë me grunë e axhës unë, policia, UDB-a që m’kanë fotografu. E besa edhe njëni, ai Halili që thashë, që ka tregu Samiu me të që ka ardhë me më marrë në Lublanë edhe ai thotë që e kanë, a din, i ka pa fotografitë ia kanë kallxu fotografitë edhe atij. E me na përcjellë po, ama s’kanë ardhë asniherë. Nuk e di pse. I ka çu shoktë Muhameri. Masanena ni shok ka qenë, vishin në shitore. Kur e shishin që s’osht’ kërkush janë afu, kanë bisedu edhe...

Anita Susuri: Ju kanë tregu për Muhamerin.

Hidajete Shabani Dërmaku: Po, po. Na kanë tregu që osht’ mirë, e kanë pa. Ky farë Hilmi a Helmi s’e di qysh po i thojnë, Hilmi Reqica.

Anita Susuri: Hilmi Reqica.

Hidajete Shabani Dërmaku: Po.

Anita Susuri: E ju çka keni, si me thanë, qysh jeni ndje a jeni gzu a keni qenë të shqetësuar që ka ikë prej burgut, a qysh e keni pritë këtë lajm?

Hidajete Shabani Dërmaku: Po të kallxova pak kam qenë e shqetësuar derisa të dalin jashtë që mundet me u bo ma keq, me vra krejt a me ra në burg, me u kthy në burg e ato torturat e ato. E tash bile folëm me ni shok të Martinit që ka qenë në burg ai me to. Tha, “Martinin”, tha, “e kanë kryqëzu si Krishtin qaq shumë e kanë torturu”. Unë edhe për Martinin jom mërzitë, s’e kom njoftë Martinin, as s’e kom ditë kush osht’ po e kom marrë me mend. Se a e din çka më thojshin ata, “Muhameri ka ra dhe ia ka kputë litarin atij shokut të vet, s’e ka lonë me ikë”. E unë e merrsha me mend që Muhameri s’ia ka bo ata, po e disha çka e ka gjetë atë të shkretin që ka mbetë në durë të tyne. Po.

Anita Susuri: Ju paraprakisht s’e keni njoftë ndoshta Martinin?

Hidajete Shabani Dërmaku: Jo, jo. Kurrë s’e kam njoftë, s’e kom pa, as s’e kom ditë bile.

Anita Susuri: Po a ju ka njoftu tani lidhur me kta personat e tjerë që kanë qenë?

Hidajete Shabani Dërmaku: Në dhomë a?

Anita Susuri: Po a veç ndoshta veç gjatë pyetjeve...

Hidajete Shabani Dërmaku: Kush? Jo, jo, ata s’më kanë kallxu kurgjo. Të kallxoj...as nuk thojshin direkt që ka ikë, po unë u bojsha që s’po di kurgjo edhe ata u bojshin që s’po të kallxojna, s’po dojna me të kallxu. Se ti po bohesh që s’po din, e na po bohemi që s’po të kallxojmë. Domethonë, ma kallxojke librin thojke, kështu a din, aty, “A p’e sheh qita?” “P’e shoh”, me...

Anita Susuri: Me provoku.

Hidajete Shabani Dërmaku: Qisi lloj provokime. “Ku ka mujtë?” Adin, atyne ju interesojke edhe ku ke mujtë me shti, ku e ke shti ti, a din, edhe tashti, “Ku osht’ ai?” Ma shkurt, se atyne edhe ju ka interesu me ditë se ku osht’ me zanë Muhamerin, po.

Anita Susuri: E qysh jeni njoftu ju me bashkëshortin e ju? Edhe ai është ish i burgosun.

Hidajete Shabani Dërmaku: (Qeshë) Po qashtu. Nejse s’kom qef me folë për këto sene edhe fmija më pysin.

Anita Susuri: Ani, veç me tregu domethonë martesën e ju? Se osht’ me rëndësi, se keni qenë grua e dhe jeni ende, grua e ni ish të burgosurit, qysh ka qenë për juve kjo?

Hidajete Shabani Dërmaku: Po na qashtu jemi lypë, jemi gjetë me qenë të ni ideje, po mendoj. Po nuk e di ka qenë qaty në dyqan isha, punojsha e këtij kumeditë i ka folë dikush, se as kta s’e kom njoftë. Ia kom ni zanin pak, po s’e kom njoftë, as s’e kom ditë kush osht’. Dikush i ka folë, a din, për mue. Ky ka qenë i pamartunm, besa i martum përpara e ka ni vajzë. Ajo aty ku osht’ në fotografi me vajzën e vet {tregon fotografinë}. I ka thanë dikush, ky ka qenë i interesum me u martu (qeshë). Me ta thanë të drejtën, hiç s’më ka interesu m’u martu. I kanë thanë, “Po pse s’po shkon te kjo...” se e ka njoftë ai babën, “Pse s’po shkon te çika e Hysenit?” Edhe çohet ky e vjen atje në shitore.

Unë isha, ai axha pati shku, se si pat vdekë qatëherë, po m’doket a nuk e di. Jo tjetër herë, s’pe di çfarë kohe ka qenë. Ka qenë ai axha tjetër, unë rrisha ma shumë vet aty në dyqan. Se kena punu bashkë me axhën po ai më lejke aty, unë e pastrojsha kur vijke najkush. Edhe erdh ky në shitore, p’i kqyrë këpucat.

Ni gru na ka pasë kthy ni parë këpuca, a din qysh janë të lëkurës përfundi ato edhe si të shkelsh në tokë jet' shenjë. I kthejshin qato, "Me m'i kthy këpucat, me m'i kthy", ato s'u kthejshin qashtu veç.

Erdh hyni në shitore, tybe s'e kom kqyrë as s'e kom pa. Tha, "Qito këpuca", tha, "ua paska kthy të bajta dikush" (qeshë). Thashë, "Po bre, çka me bo? Po përfitojnë njerëzit". Edhe dul shkoi. Mu më shkoi menja që mos prej Muhamerit diçka, a din, po. Se m'shkoj menja që s'ke bash, s'ke bash për këpuca ky njeri, po mendova që naj shok i Muhamerit edhe dul shkoi. Kish pasë shku te motra e Hidajetit, Hidajet Hyseni edhe dhondri ai Njazi Korça. Kur s'ka mbetë ajo e kish çu kunatën e vet me më thirrë a, "Hajde me shku me hangër drekë atje". U çova shkova. Kur po shkoj, po më folë ajo asi. Po më fol Samiu, Vlora, a din për vajzën. Po ma qet' përreth s'po më thotë direkt, po po ma qet' pak si përreth.

Thashë, "Për çka je ka më folë? Çka po thu", thashë, "po ky koka i martum, çka po më thu ti për to?" "Jo", tha, "s'osht' i martum", "Po kjo vajza çka osht'?" Tha, "Jo, po janë të ndamë", "Po nashta bohen bashkë more", a din une. Tha, "Jo, ka thanë jo". E nejse, "Osht' i ashpër po osht' i drejtë", e kështu e anej e te knej. Nejse, kurgjo s'i thashë, as ajo s'më tha kurgjo nejse tana. Ky u çu edhe niherë ka ardhë po dyqani plot s'ka mujtë me folë. Erdh niherë tjetër unë isha t'u e mshelë. E mshela dyqanin shkum me çikën e axhës te ni tjetër kusherinë edhe kurgjo.

Nejse, tani janë bo nja dy vjet a edhe ma as s'kemi pasë kontakt as kurgjo. Tana u kthy prapë edhe niherë. Ish i burgosun, i drejtë, i vështirë (qeshë). S'prish punë që i vështirë, po si të jenë i drejtë... edhe pranova. Vajzën, po, po, thojsha tash ajo mos me pasë as nanë as babë duhet me rritë dikush. Qishtu kemi mendu.

Anita Susuri: A ka qenë dy herë i dënuar atëherë a veç herën e parë?

Hidajete Shabani Dërmaku: Dy herë, dy herë. Dy herë po unë s'e kom ditë që ka qenë dy herë. Edhe qishtu ke kismet.

Anita Susuri: Ai fillimisht po më duket ka shku jashtë, tani ju ka marrë juve?

Hidajete Shabani Dërmaku: Po, masanena. Jo na veç jemi njoftu edhe kur tha, "Hajde", tha, "në Prishtinë edhe shifemi". Kur unë shkova, atëherë s'ka pasë telefona. Ka pasë telefon najkush aty ktu, po jo krejt. Na për veti s'kemi pasë telefon në shpi, as në shitore jo. Edhe kur vi në Prishtinë lyp s'pe gjojna kërkund, hupi. Kish pasë dalë niherë ilegal ktu nëpër Kosovë. Se qatëherë u burgosën që thashë, u burgosë ky Shemsi Sylja, u patën burgosë do shokë të vet. E ky s'i ka pritë policinë ma me ardhë me marrë. Ka dalë ilegal. Tani masanej ka ardhë ai Fazli Abdullahu, ish i burgosun edhe ai shok i Samisë.

Ma ka pru ni numër, më doket, a nuk e di edhe më ka thanë, "Me thirrë", a, "Të thirrë ai", ia kom dhanë numrin e axhës. M'ka thirrë kena folë edhe qishtu. "Hajde ti tash", kuku qysh me shku mu m'u pat'

mërzit jeta këtu a din, tanë kohën e përcjellne prej UDB-ës e sene. E tashti me të marrë me të thirrë në dasëm dikush, ni hata, a din. Shko niherë në UDB, shko niherë, u bo pak si shumë e bajat prej prindërve, prej nanës. “Hajde!” Po bash me u çu me lëshu vendin, kurrë s’e kisha menu. Kurrë s’kom pasë qef me dalë jashtë, s’e di qysh e kom vendosë. Ka qenë ni vendim tepër i zorshëm, tepër i randë edhe nuk e di pse, pse kom shku.

U çova shkova. E nana e shkreta, si tana, thojnë, “Ka ikë!” E jo ke ikë e anej, “Ke ikë!” “Jo more, s’kom ikë. Baba jem e ka ditë, nana jem e ka ditë, më kanë përcjellë. Daja jem më ka përcjellë”. Edhe u çova shkova. Vllau më ka përcjellë deri në Lublanë, Samiu. Aty ka ardhë ai... edhe gjithë kom mendu që s’ka me mujtë me dalë, kom mendu që s’muj me dalë, a din...

Anita Susuri: S’të jepin leje.

Hidajete Shabani Dërmaku: Për leje, unë pa leje kom dalë, po s’kom pasë pasaportë, unë s’kom pasë pasaportë. Ata kur më kanë arrestu herën e parë ma kanë marrë pasaportën. Jo, s’kom pasë pasaportë. Po, ai Halili kur ka ardhë ka ardhë me pasaportë të grusë të vet edhe, s’e di, nuk e di interesant osht’. Se mendojsha që muj me dalë. E kisha ni, si, si bllokadë, si me thanë si kështu, faqe e bardhë e fshime pa kurgjo. S’menojsha kurgjo hiç, as që dal, as që s’dal, as çka po bohet. Me më zonë që po më kthejnë ku po shkon a ku di une, hiç. S’kam mendu kurgjo veç asaj kur jena shku në kufi, atje në Zvicërr ata doganjerët kqyrshin në gepek. Vet me veti kqyrni atje çka të doni, se s’ka kurgjo (qeshë)

[Këtu ndërprehet intervista]

Anita Susuri: Cili vit u konë kur keni shku?

Hidajete Shabani Dërmaku: ‘86-ta, po ‘86-ta.

Anita Susuri: E qysh ka vazhdu tani jeta e juj atje?

Hidajete Shabani Dërmaku: Jeta jonë qenqe, jetë qen. Kemi shku, ky, “Jo, s’po du me të çu në kamp”. Ktyne qysh po ju thojnë tash? [I drejtohet intervistuesës] Shpi të refugjatëve ku rrijnë. Më duket kanë bo edhe ktu në Kosovë tash, po kamp. “S’po du me të çue”. Kemi nejt te ni kushti i këtij Fazli Abdullahut, te Enveri. Ajo gruja osht’ e Malishevës, e Malishevës të Gjilanit, teze e kom. S’e kom njoftë, kurrë s’e kom ditë. Rrishim aty, ajo e ka pasë ni studio qitu edhe ni dhomë të fjetjes. Merre me mend, na ka lëshu dhomën. Ajo ka flejtë në sallon, na kena flejtë në dhomë të tyne. Ajo ka punu në spital, u çu në ora 3:00 të mëngjesit me shku me punu. Ka pasë ni djalë. Veç kemi nejtë, nuk e di sa valla.

E na shku, kemi nejtë me ni podrum, kamp shpi e refugjatëve, u konë ni shpi e vogël. E ka pasë ni podrum, garazhën edhe ni dhomë qaty, ni kuzhinë të vogël, ni banjo. Banjo pa WC. Në katin përdhesë ka qenë ni i Kilit, a Guevara e ka pasë mbiemrin i Amerikës Latine, nuk e di. Në katin e parë ka qenë ni i

Deçanit, shqiptar me katër-pesë fmi. Qaty kemi nejtë nja ni vjet e tepër, gati dy. Aty na ka lindë vajza. E ky vallai, “Hajde po shkojna me lypë punë”, a din për kto si inxhinier që e ka pasë kry fakultetit. Shkojshim, janë ato sikur, edhe tash ktu janë bo do byro a qysh ju thojnë ktyne për punësim.

Anita Susuri: Po, si agjenci.

Hidajete Shabani Dërmaku: Si agjenci, po. E besa i patën çu nja dy letra me punu kishe si inxhinier. Po atëherë na ishim refugjatë edhe ai asistenti, domethonë ai i socialit, “Jo”, tha, “ti s’ki të drejtë me punu si inxhinier se”, tha, “s’të njifet diploma jote këtu”, edhe e mori e shkyjti letrën. “S’ki të drejtë me punu, ti”, tha, “me punu si elektrikist”. E ia ka pasë gjetë njëni ni punë si elektrikist. Masnej shkoi punoi dy javë edhe po get ata intervenunë e qitën prej punës. Edhe na i patën nalë edhe ndihmat. As ndihma s’na jepshin se ky s’u bindke, nuk e di. E s’kishim as... atë azilin s’na jipshin se e ka refuzu atë përkthysin serb, s’ka deshtë me folë.

Ata s’na jepshin as dokumente. Shumë ish keq me qenë pa kurfarë dokumenti me ni vend të hujë, pa kurgjo. Na s’ishim mësu. Nime unë s’kom pasë letërnjoftim, derisa e kom nxjerrë pasaportën s’kom pasë. S’na ka lypë kurrë kërkush, s’na ka vy kurgjo. Atje as s’të japin banesë, as s’të lojnë me punu as... si të mos kish banesë, çka me bo pa pasë kulm përmbi kry? Kur kena pasë shku qaty në qat’ podrumin, kur shkum po më thotë ai, “Qysh po të doket?” Ai asistenti, “qysh po të doket ktu zonja Dërmaku?” Më thojke ai, s’e dike se na atëherë s’jena konë të martum hala. Thashë, “Mirë”, thashë, “po më doket”.

U gëzova e kishim çelsin me çelë derën edhe me mshelë, jo me shku me i prit te dyrtë e huja, po. Çka s’kom provu në këtë jetë. Thashë, “Shumë mirë”. “Ti” tha, “koke e guximshme që po të pëlqen ktu”, ajo krejt beton. Aty do kauqa të zhytun, të zhyllaftë, kumeditë kush ka flejtë e kush s’ka flejtë aty. Qaty kemi nejtë dy vjet gati.

Anita Susuri: A ka qenë kjo koha kur jeni taku edhe me Muhamerin?

Hidajete Shabani Dërmaku: Po, po, na si kena shku Muhameri ka ardhë. Unë kom shku të dillën, ai ka ardhë të hanen. Ka ardhë të hanën meniherë me u taku me mu.

Anita Susuri: Mas sa kohe?

Hidajete Shabani Dërmaku: Meniherë.

Anita Susuri: Jo, jo. Masi...

Hidajete Shabani Dërmaku: A kështu.

Anita Susuri: Mas nja tre-katër vjete jeni pa?

Hidajete Shabani Dërmaku: Dy vjet nashta. Se ai në '83-tën, jo tri vjet tamon po i bjen, mas tri vjete.

Anita Susuri: Qysh ju dokë ai bashkim?

Hidajete Shabani Dërmaku: I prekshëm, i prekshëm, i prekshëm. Na kemi qenë shumë të lidhun me Muhamerin.

Anita Susuri: Muhameri osht' po më doket i katërti fmi?

Hidajete Shabani Dërmaku: Jo, i treti. Po, i treti osht'.

Pjesa e Gjashtë

Anita Susuri: Qysh ka vazhdu tani jeta e juv aty, domethonë karshi aktivitetit që e ka bo bashkëshorti juv? A e keni ndihmu edhe juv?

Hidajete Shabani Dërmaku: Po, qysh s'e kom ndihmu. Nejse, ky i ka bo kto aktivitete, po tani më thojke, unë i bona fmijën, "Hajt ti merru me gratë". Ktu nuk... atje nuk je sikur ktu që e ki hallën a tezën a kojshinë a, atje s'i intereson kërkujt për ty. Ti je vet. Kërkush s'i kqyrë fmitë e tu. Po besa kur kam shku atë vjet ka pasë ardhë njëni Michel i thojshin, Michel s'e di qysh e ka pasë mbiemrin në sindikatë punojke. Edhe ai ka pasë kontakte me shqiptarë, e ka pasë pak fmi. S'ka pasë shumë fmi shqiptarë atëherë, hala ka pasë pak fmi shqiptarë.

E ka marrë vesh që unë jom msuse edhe erdh ni ditë në mëngjes. Bile, Samiu s'ish aty hiç edhe e shtina mrena. Tha, "Me shkru ni thirrje shqiptarëve që me organizu, a je dakord ti me ju dhanë mësim nxanësve shqiptarë?" Thashë, "Po, more". Edhe [hajde] me shkru atë thirrjen. E tashti unë e shkrujsha shqip ai ka mujtë e ka shkru, e ka shtyp në maqinë a nuk e di çka ka bo. Po ka dalë thirrja me shumë gabime. Ua ka çu shqiptarëve me thirrë ni mbledhje, m'u taku për fmitë shqiptarë. Kur e marrin shqiptarë thirrjen e shofin ka qenë, ni, osht' i Shkupit, Ismail Hyseni, po. "Shka osht' kjo thirrje kështu? Kush e ka shkru? Pse e ka shkru me gabime?" Tani jo veç ai, po krejt. Po ti a osht' ni thirrje, e ka bo ai zvicërrani për shkollë shqipe, për fmitë shqiptarë, çka po nxjerrë qiqrra në hell që thojnë.

U majt ajo mbledhja, shkum edhe unë e Samiu. Edhe u majt mbledhja edhe njani i thumit, tjetri i patkoit u zgjatë kjo mbledhja sa t'dush edhe kurgjo s'bonën. U çuditë ai zvicërrani tha, "S'kom pa", tha, "unë kështu sikur ju mos me mujtë me u marrë vesh kurfare". Nejse, u anulë ajo. E kanë thirrë ni mbledhje tjetër, kur u bo mbledhja tjetër Samiu tha, "Na s'po shkojna hiç". Dhe e kanë bo, nuk e di se çka kanë bo tybe n'e disha. Masanena, "Hajde me shku". E kisha vajzën e vogël, ka ardhë ajo, njana me ma kqyrë sa të jom. As shkollë, as shkumsa s'kish, as fletore as kurgjo, kurgjo hiç. Menzi i bonëm me shku në

qendër të socialit të protestanëve, të protestanëve, si kishë. Po edhe jepshin kurse qaty e kena mësu edhe na frengjisht kah pak me Samin shkojshim.

E kena pasë ni kurs shkojshim para dreke tri orë, tani në drekë shkojshim, ni orë ajo u konë pa pare, a din, gratis shkojshim prapë me mësu gjuhën. Edhe qaty. Nejse, tana i nalën fmijën, i nalën shqiptartë edhe mu më konvenojke se s'mujsha moj, s'kishim kurgjo. Tash kur po ankohen këto msuset, rrogat e vogla, me u çu me shku, as pare për biletë të autobusit s'kisha. Qashtu, tana ky ia nisi herë me njanin herë me tjetrin jo me i pajtu, kta su pajtojshin. A mund me i mbledhë pleshtat n'thes me i shti? Qaq shqiptartë (qeshë). E ky nëpër mbledhje mu m'thojke, "Hajt boni gratë". E kena bo aktivin e grusë atje në Gjenevë, qat' shoqatën.

E i thirrshim, tani ishin çu ni ditë do farë, "Jo, s'po punoni boll", na me u tubu niherë në mujt boll u konë, gratë shqiptare. Me u taku njana me tjetren, me kajt ni hall e ni dert e sa me bo diçka. E patëm organizu, se di cili vit ka qenë, qat' vit që u rrxunë dy aeroplana nuk e dini ju, s'keni qenë hiç. Janë rrxu dy aeroplana për ni vit, njani u rrxu në mars, na e bonëm për 8 mars tubimin. E patëm bo ma herët, e patëm bo mend, tani u bo kjo puna e aeroplanit e thojshin, "Jo, qysh me bo muzikë..."

Anita Susuri: Cili vit u konë?

Hidajete Shabani Dërmaku: Tybe të rrej, '90-ën nashta.

Anita Susuri: Aeroplanat e cilit vend janë konë?

Hidajete Shabani Dërmaku: Po me shqiptarë (qeshë). S'e di të kahit kanë qenë veç me shqiptarë plot. Njo u rrxu në Ohër, e tjetri tybe s'e di, në Shkup a...

Anita Susuri: Qikjo në Ohër po më duket kom ni për to.

Hidajete Shabani Dërmaku: Po, po, ai në Ohër u rrxu në dhjetor e ky tjetri s'e di ku u rrxu. Po nashta në Shkup, në Shkup se atëherë s'ka pasë në Prishtinë hala. Qashtu. E kto tubimet, "Hajde në shoqatë", e ky u bo kryetar i shoqatës e niherë s'u konë, s'e di qysh. "Hajde me gatu, hajde me çu, me bo tubimet", me ia bo bukën gati ktina me i pritë shoktë e ktina. Që tha ajo gruja e Kadri Osmanit, tha, "Ia kom duru shoktë", thashë, "Tybe shoktë i kom duru se m'kanë respektu, po e kom duru kta ma shumë", (qeshë). Shoqnia hyn e dil e bojshin mbledhje, jo anej jo te knej. Me shku nëpër tubime, nëpër demonstrata herë në Cyrih, e herë në Bern, e herë në Genevë.

Anita Susuri: A keni shku ju?

Hidajete Shabani Dërmaku: Po moj qysh jo. Kuku, kuku, kuku me bo mos me shkue... jo kena shku. Po nejse ish e vetmja dalje qatëherë. Takime dhe çka thojshin fmija kur shkojshim në demonstrata, "Po

shkojna në Kosovë”, (qeshë). Tek i nijshin t’u bërtitë, “Kosova Republikë”. “Ku po shkoni? Po shkojna në Kosovë”. E po du me të kallxu pastaj ‘90-ën i kom pasë dy fmi. Djali pa i bo ni vjet e vajza i ka pasë gati dy vjet e gjysë. Kjo farë festa e Pashkëve ku mahet në ‘90-ën, pat’ ardhë Vlora, ish në Gjenevë pat’ ardhë në ‘89-tën në vjeshtë. Edhe kishin organizu ni autobus me ardhë për Pashkë, shqiptartë a din me ardhë në pushim.

Samiu po thotë, “Le të shkon Vlora, le të rrin nja ni javë në Kosovë”. Edhe tash ajo Vlora po bohet gati. Kjo Mimoza, kjo vajza e vogël po shkon po e kqyrë, lakmojke. Tha, “Kuku”, masnena thashë, “po lakmon Mimoza”, tha, “Mos po lakmon ti najka?” Thashë, “Po valla”, thashë, “m’ka thanë Sadia veç shko shife nanën se ta japi pasaportën”, edhe motra e kunatës, grusë të Muhamerit. Thashë, “Edhe Ludja m’ka thanë ta japë pasaportën si dush me shku në Kosovë”, edhe u çu ka shku, 150 kilometra osht’ Gjeneva prej Bilit. Ka shku ma ka marrë pasaportën e balldyskës së Muhamerit edhe e bonëm mend me ardhë me nejt nja ni javë ditë ktu.

Kur jena hypë në autobus tha, “Jo”, tha, “kthehu me qit autobus”, për dy ditë. Thashë, “Ani”. Edhe çohemi edhe vijna me pasaport të hujin. E kta nana s’e ka ditë hiç. E shkova. Kur hinëm në katun kena mrri në 11:00 të natës, e premtë më doket ka qenë, 11:00 të natës. E unë e kom qit’ ni batanije në kry mos me më njoftë (qeshë). Mos me m’njoftë njerëzit edhe kom shku në shpi. Kur ka hy, ka hy Vlora përpara i ka thanë, “Osht’ edhe Hida përmas”, a din, nanës. Ajo nana ka nga, ajo kunata, “Kuku u tranu nana, u tranu nana çka ka që po nget” (qeshë).

Anita Susuri: Ajo s’e ka ditë.

Hidajete Shabani Dërmaku: Po de, s’e ka ditë. E qishtu. Nejta qat’ natë edhe ni natë më duket edhe të hanën jom kthy. Të shtunën, të dillen kom nejtë të hanën më duket jom kthy, po. E qishtu. Gurbeti ish shumë shumë i randë. Nganjëherë thojsha po më lun tipiliku i kresë. Thojsha qysh, si m’u doke dita e gjatë, koha e gjatë ni shekull. Thojsha, a bohet, a ka, s’u shifke kurfarë shenje që do të bohet diçka.

Anita Susuri: Kur ka shpërthy lufta, a keni pasë ma kontakt me familjen, a qysh jeni...

Hidajete Shabani Dërmaku: Kur ka shpërthy lufta në Gilan, atëherë me Gilan folshim. Kta në katund i kanë qit’ prej shpisë, i kanë, i kishin pasë nxjerrë a une s’kom ditë kurgjo. Para se me shku në punë prej banesës, kur u nalsha, shkojsha me autobus kur u nalsha me ni stacion prapë zbritsha prej autobusit edhe aty hisha në kabinë derisa vijke autobusi tjetër me thirrë në telefon me provu me marrë lidhjen se s’u merrke lidhja.

Besa u tmerrojsha, thojsha, me thirrë thojsha, se përballë atje në Ulpianë ia kanë pru policinë në ndërtesa, qaty ka banu Rexhep Qosja, Sadri Fetiu e kanë qenë krejt kta farë... thojsha ata ballë përballë veç rruga, thojsha p’e nijne kur të kërset telefoni, po ju shkojnë, po ju hijne mrenda serbët,

shkijet⁶. Mos me thirrë nuk e dijsa çka po ndodhë. Kur e merrsha lidhjen dy-tri fjalë s'kishe ma shumë edhe prapë u çlirojshe pak, kokan gjallë hala. Tani dikur edhe atyne ua nalën telefonin, te dajhtë.

M'ka pasë thirrë daja jem niherë, o zot sikur prej vorrit kur t'thirrën, si prej vorrit. Ai i kanë pasë, kanë qenë malazezë do kojshi, i kanë pasë poshtë, anën e poshtme. Valla kanë qenë të mirë ata. E thirri niherë ata Marian, grunë e Stevës, thashë, "Oj", qysh disha unë me folë serbisht kom harru, "qysh janë?" "Mirë janë, mirë janë. Po i shof, e kom pa para shpijes Nazimin. Mirë janë, po s'muj me shku". Se ata i kishin pasë krejt kta policinë në shpi, t'u nejt te ta.

Tana dikur nuk e di se ku ka dalë prej diku m'ka thirrë edhe niherë djali dajës. Kta të Samisë shkojshin folshin dikund rendi t'u pritë rend ata me folë me të vetit jashtë në telefon. Me folë dy fjalë me të vetë. Ka qenë shumë e randë. Bile me njënin folëm, ni vendas të burrit ni ditë, po thotë, "Shumë ka qenë rond", thashë, "S'po thom edhe na e kemi pasë rond sa ju, se s'krahsohet. Nuk muj me krahasu, s'e lejoj vetën me krahasu, veç edhe na shumë vështirë e kemi pasë. Shumë vështirë e kemi pasë". Se nuk e dishe se çka po ndodhë, nuk e dishe çka po ndodhë. Kur t'i kesh njerëzit e tu, tokën tande, vendin tond. E për babën tem kur kom marrë vesh që i kanë qit' prej shpisë jom mërzitë (qan), jom mërzitë shumë, shumë jom mërzitë.

Anita Susuri: E kur u kry lufta, mas sa kohe ju keni ra në kontakt me familjen që janë mirë krejt?

Hidajete Shabani Dërmaku: Jo pastaj kur kanë shku në Shkup, atje në Stankovec. Motra ka pasë dalë në Tetovë përpara, para ktyne. Kta, se ajo ka shku prej Prishtine nuk e di se qysh tybe, kurrë s'e kom vetë, nuk e di se qysh. Ka dalë me vajzën e dajës kanë shku në Tetovë. Ajo m'ka thirrë motra, kena folë, kena folë rregullisht. Bile e kom hala dikund numrin e atyne tetovarëve. Shumë i kanë pritë mirë. Edhe mora vesh që kta niherë në Stankovec. Tani i kom kallxu motrës më duket, a nuk e di a i ka kallxu dikush tjetër, e ajo ka shku i ka pa në kamp.

Na e kemi, nana i ka pasë dy djel edhe të axhës edhe të tezës, kusheri në Shkup. Po ata plot shpijat, njani në banesë ka qenë s'ka pasë shpi. Ky tjetri... edhe ju kanë shku prej të vetve, po mendoj të axhallarëve. S'kishin ku me i çu. Me i nxjerrë prej Stankovecit u dashke me e pasë ni vend ku me i çue prej kampit. E i kom thirrë ni, djemtë e hallës të djemve të hallës, kunatës të hallës të madhe. Ata në Zvicërr janë në Kumanovë në Lllupat, ni katund aty. I kom thirrë ata, "A po i pranoni?" Se kallabllak kta. Njëherë thanë, "Jo, se jena t'u i pritë dajhtë", për dajhtë e vetë, kta të hallës. Po tana masanej i morën valla.

E ka shku motra i ka nxjerrë. Nuk e di qysh i ka nxjerrë, qysh ka shku ajo farë telashe se keq aty, kushtet e kqija nëpër kampe me çadra, viron. E kanë shku kanë nejtë atje në Kumanovë, në Lllupat. Pastaj, vllau që osht' në Holandë ju ka bo, i ka marrë atje, i ka marrë në Holandë. E, kom shku atje në Holandë i kom

⁶ Term derogativ për komunitetin serb.

vizitu në kamp, jo në kamp, po më duket ma tepër sikur kto kazerma të ushtrisë. I kishin pasë, krejt shqiptarë kanë qenë...

Anita Susuri: I kanë shndërru si kampe a qysh?

Hidajete Shabani Dërmaku: Po de, po. Po ato sallat e fjetjes ato të mdhaja, a din, kreveta shumë e sende. Ato veç, po mendoj, ma merr mendja me ato farë kabinat e përbashkëta ku di une. Veç e ushtrisë ka qenë. I ushqejshin aty, e kanë pasë restaurantin, bukën e kanë pasë të gatshme me hangër aty e me fjetë aty mirë, s'e kanë pasë vallai keq. E kom pasë shku, kom pasë nejtë edhe unë dy javë me ta me fmi. I mora fmitë shkova me tren, qishtu. Tana baba nuk mujti me nejtë aty, se atyne nuseve të djemve dove ju ka mbetë merak me nejtë, po ky s'i ka lonë.

Anita Susuri: Me nejtë ku?

Hidajete Shabani Dërmaku: Në Holandë, në Holandë.

Anita Susuri: Janë kthi krejt mas lufte?

Hidajete Shabani Dërmaku: Janë kthi krejt.

Anita Susuri: E qysh e morët lajmin që u kry lufte?

Hidajete Shabani Dërmaku: Hiç s'e di. Po kur kena marrë vesh që po bombardon NATO-ja jemi gëzu shumë. E bile ma ka pasë zanë për të madhe djali i axhës, se ata janë frikësu, a din. Ata kanë qenë në Gjilan aty. Kur i kom thirrë në telefon i kom thanë, kumeditë çka i kom thanë, as vet s'e di. Jom gëzu se s'e kom pasë me qëllim të keq. "Na", tha, "na u dridhshim ti..." (qeshë). S'e di tash, nuk di me të kallxu. Po du me thanë, jemi gëzu veç që ia nisën bombardimet e le ta shohin edhe ata [serbët] qysh osht'.

Anita Susuri: E tani mas luftës kur jeni kthi në Kosovë?

Hidajete Shabani Dërmaku: 2000-tën, 2000-tën.

Anita Susuri: Qysh ju ka dokë vendi?

Hidajete Shabani Dërmaku: Qysh m'u ka dokë? Mos m'i përkujto (qan). Ti e din qysh ka qenë, a e din? A ke qenë? Sa vjet i ke pasë?

Anita Susuri: I kom pasë nja tetë vjet.

Hidajete Shabani Dërmaku: Tetë vjet. Na kemi ardhë në Shkup atëherë me aeroplan, unë me fmi. Kta kanë dalë me na marrë në kufi. Unë s’e di tybe, më doket kom ardhë me taksi deri te kufini Kosovë-Maqedoni edhe kemi ardhë ktu. Kemi ecë atëherë, kemi shëtitë besa, kena pasë shku edhe te kullat e Jasharëve edhe te krejt ato. Më duket që po i shoh shpijat, veç oxhaqet.

Thojshin fmitë e mi, “Ktu mbeturinat, bërllongi”, përskej rrugës, “A s’e njofin kta...” (qeshë), vendin ku hiqet bërllogu, a din, tash (qeshë). “O moj nanë, hajt se s’ka gajle”. Ai bërllogu i madh u hoq e... kështu kom mendu, kom thanë me rëndësi u hoqën ata. Tash kta çka dojnë le të bojnë, se na boll jemi mundu, jemi rrjepë t’u nga nëpër demonstrata, t’u nga nëpër tubime, me pritë e me përcjellë, e me duru e me çduru.

Anita Susuri: Nëse doni edhe diçka me shtu për fund, diçka që keni harru.

Hidajete Shabani Dërmaku: Nashta kom harru (qeshë). O çka ka, ka plot (qeshë), ka plot kurrë... osht’ ni, 36 vjet a edhe masanena, 36 vjet. Fmija u rritën atje, e me ardhë këtu, kur erdhëm u nalke rryma, kushtet katastrofike, katastrofë. Për mue boll që isha ktu, se kur erdha atëherë me qebe në kry për dy netë ish shumë mirë. Po çka me bo. S’di çka thom tjetër.

Anita Susuri: Ani faleminderit pra shumë për intervistën edhe kohën.

Hidajete Shabani Dërmaku: Nderë paqi.